



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2016 – Numri: 99

Tiranë – E mërkurë, 8 qershor 2016

PËRMBAJTJA

		Faqe
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 397, datë 1.6.2016	Për miratimin e marrëveshjes së grantit nr. TF0A1769, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim, që vepron si administratore e fondeve të grantit të akorduar nga Fondi i Mirëbesimit me Shumë Donatorë, për financimin e projektit të zbatimit të Nismës për Transparencë në Industrinë Nxjerrëse në Shqipëri (EITI).....	5575
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 398, datë 1.6.2016	Për kriteret dhe masën e përfitimit të pagesës së qirasë për strehim për punonjësin e Policisë së Shtetit.....	5588
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 399, datë 1.6.2016	Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 55, datë 27.1.2016, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e paraqitjes, formës dhe specifikimeve teknike të gradave, simboleve, uniformave dhe shenjave të Policisë së Shtetit”.....	5589
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 400, datë 1.6.2016	Për pjesëmarrjen e Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë në operacionin ushtarak të Bashkimit Evropian, me mision trajnues, në Republikën e Malit, në Afrikë.....	5592
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 401, datë 1.6.2016	Për miratimin e strategjisë afatmesme të menaxhimit të borxhit 2016–2018.....	5593
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 402, datë 1.6.2016	Për një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2016, miratuar për Kryeministrinë.....	5630
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 407, datë 1.6.2016	Për përcaktimin e kriterit të notës mesatare për pranimin e kandidatëve në programet e studimeve të ciklit të parë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, në institucionet e arsimit të lartë, për vitin akademik 2016–2017.....	5630

Vendim i Këshillit të Ministrave
nr. 408, datë 1.6.2016

Për një shtesë në vendimin nr. 646, datë 1.10.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për kalimin e pronës së paluajtshme shtetërore, me emërtimin “Ish-Drejtorja e Konvikteve të Shkollave të Mesme, Tiranë”, në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Drejtësisë, dhe për një ndryshim në vendimin nr. 834, datë 13.12.2006, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e listës së pjesshme të inventarit (pjesa e parë + pjesa e dytë) të pronave të paluajtshme shtetërore në Bashkinë Tiranë, të qarkut të Tiranës”, si dhe për një shtesë në vendimin nr. 1292, datë 24.9.2008, të Këshillit të Ministrave, “Për kalimin në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Drejtësisë të trojeve dhe ndërtesave të gjykatave të rretheve gjyqësore dhe të gjykatave të apelit”, të ndryshuar”.....



VENDIM

Nr. 397, datë 1.6.2016

**PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES SË
GRANTIT NR. TF0A1769, NDËRMJET
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE
BANKËS NDËRKOMBËTARE PËR
RINDËRTIM DHE ZHVILLIM, QË
VEPRON SI ADMINISTRATORE E
FONDEVE TË GRANTIT TË AKORDUAR
NGA FONDI I MIRËBESIMIT ME
SHUMË DONATORË, PËR FINANCIMIN
E PROJEKTIT TË ZBATIMIT TË NISMËS
PËR TRANSPARENCË NË INDUSTRIJË
NXJERRËSE NË SHQIPËRI (EITI)**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 17 e 23, të ligjit nr. 8371, datë 9.7.1998, “Për lidhjen e traktateve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare”, me propozimin e ministrit të Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e marrëveshjes së grantit nr. TF0A1769, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim, që vepron si administratore e fondeve të grantit të akorduar nga Fondi i Mirëbesimit me Shumë Donatorë, për financimin e projektit të zbatimit të Nismës për Transparencë në Industrinë Nxjerrëse në Shqipëri (EITI), sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI

Niko Peleshi

BANKA BOTËRORE

IBRD IDA/GRUPI I BANKËS BOTËRORE

26 shkurt, 2016

Sh.t. z. Arben Ahmetaj

Ministër i Financave

Ministria e Financave

Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”

Tiranë, Shqipëri

***Fondi i Mirëbesimit me Shumë Donatorë
për Nismën për Transparencë në Industrinë
Nxjerrëse (EITI), Shqipëri, në mbështetje të
procesit si vend zbatues për projektin “Nisma
për transparencë në industrinë nxjerrëse”***

*(letërmarrëveshja) granti**nr. TF0A1769*

Shkëlqesi,

Në përgjigje të kërkesës për ndihmë financiare të bërë në emër të Republikës së Shqipërisë (Marrësi), kam kënaqësinë t’ju informoj se Banka Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim (Banka Botërore), në cilësinë e administratorit të fondeve të grantit të dhënë nga Australia, Belgjika, Kanadaja, Danimarka, Bashkimi Evropian, i përfaqësuar nga Komisioni Evropian, Finlanda, Franca, Gjermania, Japonia, Holanda, Norvegjia, Spanja, Zvicra, Mbretëria e Bashkuar dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës (donatorët), në bazë të Fondit të Besimit me Shumë Donatorë për Shqipërinë për Zbatimin e Nismës për Transparencë në Industrinë Nxjerrëse (EITI), propozon të vazhdojë t’i japë marrësit një grant në shumën që nuk tejkalon katërqind mijë dollarë amerikanë (400,000 US \$) (Granti), sipas termave dhe kushteve të përcaktuar ose të përmendur në këtë dokument marrëveshjeje (Marrëveshja), e cila përfshin shtojcën bashkëlidhur, për të asistuar me financimin e Projektit të përshkruar në shtojcë (Projekti).

Ky grant financohet nga fondi i lartpërmendur i besimit për të cilin Banka Botërore merr kontribute periodike nga donatorët. Në pajtim me seksionin 3.02 të kushteve standarde (siç përcaktohet në shtojcën e kësaj Marrëveshjeje), detyrimet e pagesave të Bankës Botërore në lidhje me këtë marrëveshje kufizohen në shumën e fondeve të vëna në dispozicion të saj nga donatorët, sipas fondit të lartpërmendur, dhe e drejta e Marrësit të tërheqë paradhënien i nënshtrohet disponueshmërisë së këtyre fondeve.

Marrësi përfaqëson, duke konfirmuar pëlqimin e tij si më poshtë, se ai është i autorizuar ta nënshkruajë këtë Marrëveshje dhe të realizojë Projektin në përputhje me termat dhe kushtet e parashikuar ose të përmendur në këtë Marrëveshje.

Ju lutem, konfirmoni pëlqimin e Marrësit për sa më sipër, nëpërmjet nënshkrimit, vendosjes së datës dhe kthimit të ne të kopjes së bashkëlidhur të kësaj Marrëveshjeje. Kjo Marrëveshje do të hyjë në fuqi në datën në të cilën Banka Botërore i dërgon Marrësit njoftimin e pranimit për njoftimin e marrësit se ekzekutimi dhe dorëzimi i kësaj Marrëveshjeje është autorizuar ose ratifikuar sipas legjislacionit të Marrësit.



Me respekt,
**BANKA NDËRKOMBËTARE PËR
 RINDËRTIM DHE ZHVILLIM**

Nga _____

Tahseen Sayed

Menaxhere Vendi

Zyra e Bankës Botërore, Shqipëri

RËNË DAKORD:

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Nga _____

Përfaqësuesi i autorizuar

Emri _____

Pozicioni _____

Data _____

Shtojca:

1. Kushtet standarde për grantet e zbatuara nga Banka Botërore nga fonde të ndryshme, të datës 15 shkurt 2012.

2. Letërdisbursimi e të njëjtës datë me marrëveshjen, së bashku me udhëzimet e disbursimit për projekte të Bankës Botërore, e datës 1 maj 2006.

3. “Udhëzime për parandalimin dhe luftën kundër mashtrimit dhe korrupsionit në projektet e financuara nga “Huat e IBRD-së dhe kreditë dhe grantet e IDA-s”, të datës 15 tetor 2006 dhe të rishikuara në janar të vitit 2011.

4. Udhëzimet: Prokurimi i mallrave, punimeve dhe shërbimeve jokonsultative sipas “Huas së IBRD-së dhe kredive dhe granteve të IDA-s” nga Huamarrësit e Bankës Botërore, janar 2011 dhe të rishikuara në korrik 2014.

5. Udhëzimet: Përzgjedhja dhe punësimi i konsulentëve sipas huave të IBRD-së dhe kredive dhe granteve të IDA-s nga Huamarrësit e Bankës Botërore, janar 2011 dhe të rishikuara në korrik 2014.

Granti EITI NR. TF0A1769
SHTOJCË

Neni 1

Kushtet standarde, përkufizimet

1.01 Kushtet standarde. Kushtet standarde për grantet e marra nga Banka Botërore nga fonde të ndryshme të datës 15 shkurt 2012 (Kushtet standarde) përbëjnë pjesë integrale të kësaj Marrëveshjeje.

1.02 Përkufizimet. Përveç kur konteksti e kërkon ndryshe, termit me germa kapitale të përdorur në këtë marrëveshje kanë kuptimet që u janë dhënë në Kushtet Standarde apo në këtë Marrëveshje.

a) “Organizata të shoqërisë civile” nënkupton organizata joqeveritare, media dhe grupe të rinjve.

b) “EITI” nënkupton Nismën për Transparencë në Industrinë Nxjerrëse.

c) “Sekretariati Kombëtar EITI” nënkupton sekretariatin në kuadër të Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë të Marrësit, i krijuar në bazë të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 540, të datës 7.7.2010 apo pasuesit ligjor të tij.

d) “MEI” nënkupton Ministrinë e Energjisë dhe Industrisë të Marrësit apo pasuesin e tij ligjor.

e) “Grupi i punës me shumë aktorë” ose “MSG” nënkupton një grup të përbërë nga përfaqësues të qeverisë përfituese, shoqëritë minerare dhe shoqërinë civile, dhe të ngritura nga Përfituesi, për të marrë vendimet në lidhje me procesin e EITI-së.

f) “Kosto Operative” nënkuptojnë kosto të arsyeshme dhe në rritje të bëra nga Sekretariati Kombëtar EITI dhe MSG, në llogari të shpenzimeve për udhëtim, si dhe shpenzimeve të tjera të arsyeshme të rëna dakord me Bankën Botërore, të cilat drejtpërdrejt të lidhura me zbatimin e projektit.

g) Trajnim nënkupton shpenzime (të ndryshme nga shërbimet e konsulencës) të bëra gjatë zbatimit të Projektit, bazuar në buxhetin periodik të pranuar nga Banka Botërore, për: i) udhëtime të arsyeshme, dhoma, udhëtime me avion dhe për shpenzime për dieta të bëra nga trajnues dhe të trajnuarit në lidhje me trajnimet e tyre; ii) shpenzime kursi; iii) lehtësira në trajnime/seminare dhe marrje me qira të pajisjeve; dhe iv) përgatitje të materialeve trajnuese, përvetësimin, prodhimin dhe shpërndarjen e shpenzimeve, të cilat ndryshe nuk janë të përfshira në këtë paragraf.

Neni 2

Ekzekutimi i projektit

2.01 Objektivat dhe përshkrimi i projektit. Objektivat e projektit janë asistimi i Marrësit për zbatimin e axhendës EITI. Projekti përbëhet nga pjesët e mëposhtme:



Pjesa A. Mbështetje për zbatimin e EITI-së

Mbështetja e Marrësit për të arritur dhe mbajtur detyrimet për statusin e vendit zbatues, duke përfshirë rekrutimin e: i) administratorit të pavarur për të mbikëqyrur përgatitjen e dy raporteve vjetore EITI që përfshijnë të gjithë sektorin e industrisë nxjerrëse për vitin kalendarik 2015 dhe 2016; dhe ii) një ekspert ligjor për të zhvilluar një pasqyrë ligjore dhe rregullatore për të identifikuar faktorët që ndikojnë në mbledhjen e ngadaltë të të dhënave për përgatitjen e raporteve EITI dhe rekomandimeve përmirësuese.

Pjesa B. Ngritja e kapaciteteve

Ofrimi i asistencës teknike dhe trajnimeve kryesore mbi EITI-në dhe menaxhimin e burimeve natyrore nëpërmjet: i) zhvillimit të trajnimeve të personalizuar për grupet e përshtatshme të interesit në industrinë nxjerrëse, duke përfshirë Sekretariatit Kombëtar EITI dhe MSG-në, shoqërinë civile për çështje të lidhura me industrinë nxjerrëse, Standardin EITI dhe mbi të gjitha transparencën në sektor; dhe ii) ofrimin e shërbimeve teknike këshilluese për agjencitë shtetërore dhe shoqëritë vepruese në industrinë nxjerrëse për të trajtuar nevojat e tyre të veçanta në përputhje me kërkesat e EITI-së.

Pjesa C. Komunikimi dhe sensibilizimi

Mbështetje në zbatimin e Strategjisë së Komunikimit për vitin e parë të Zbatimit të Projektit, duke përfshirë: i) ofrimin e mbështetjes për printimin dhe fushata sensibilizuese në median vizive për të mbështetur Sekretariatit Kombëtar për të publikuar dhe shpërndarë informacione kryesore në publik; ii) rritjen e ndërgjegjësisë përmes eventeve të organizuara, duke përfshirë konferenca për shtyp dhe seminare për të rritur kuptueshmërinë e çështjeve kryesore që lidhen me industrinë nxjerrëse; dhe iii) menaxhimin e faqeve të internetit të EITI-së shqiptare dhe llogarive në median sociale.

Pjesa D. Menaxhimi i projektit

Fuqizimi i kapacitetit të Sekretariatit EITI për të ndërmarrë menaxhimin e projektit përmes: i) rekrutimit të shërbimeve të një specialisti të specializuar të teknologjisë së informacionit dhe një specialisti prokurimi mbi baza kontraktuale; dhe ii) kosto financiare operative.

2.02 Zbatimi i projektit në përgjithësi. Përfituesi deklaroi angazhimin e tij ndaj objektivave të projektit. Për këtë qëllim, Marrësi do të zbatojë

projektin nëpërmjet Sekretariatit Kombëtar EITI në përputhje me dispozitat e: a) seksionit II të kushteve standarde; b) udhëzimeve për parandalimin dhe luftën kundër mashtrimit dhe korrupsionit në projektet e financuara nga kreditë e IBRD-së dhe kreditë dhe grantet e IDA-s, të datës 15 tetor 2006 dhe të rishikuara në janar 2011 (Udhëzimet e antikorrupsionit); dhe c) të këtij neni

2.03 Masat institucionale dhe masa të tjera. Për arsye të zbatimit të projektit, Marrësi duhet të:

a) Garantojë që Sekretariatit Kombëtar EITI do të koordinojë aktivitetet e projektit dhe do të ndërmarrë detyrat/operacionet e përditshme me kujdesin dhe efikasitetin e duhur;

b) Në çdo kohë, gjatë të gjithë zbatimit të projektit, marrësi do t'i sigurojë sekretariatit të EITI-së ambiente zyre, pajisje të nevojshme zyre dhe do të mbulojë të gjitha shërbimet dhe furnizimet; dhe

c) Marrësi nuk do të përdorë të ardhurat e grantit për qëllimin e ndonjë pagese ndaj personave ose subjekteve ose për importin e mallrave, nëse pagesa ose importet të tilla, sipas dijenisë apo mendimit të Përfituesit, janë të ndaluara me vendim të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara, bazuar në kapitullin VII të Kartës së Kombeve të Bashkuara, sipas rezolutës së Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara 1373 dhe rezolutave të ngjashme.

2.04 Vizibiliteti dhe vizitat e donatorëve: a) Përfituesi duhet të ndërmarrë nëpërmjet Sekretariatit Kombëtar EITI ose të mundësojë marrjen e të gjitha masave që Banka Botërore mund të kërkojë në mënyrë të arsyeshme për të identifikuar publikisht mbështetjen e donatorit për projektin.

b) Për qëllime të seksionit 2.09 të Kushteve Standarde, nëpërmjet Sekretariatit Kombëtar EITI e me kërkesë të Bankës Botërore, Marrësi do të marrë të gjitha masat e nevojshme për të mundësuar përfaqësimin e donatorëve për të vizituar çdo pjesë të territorit të Marrësit për qëllime që lidhen me projektin.

2.05 Dokumentet: Të dhënat

Në vijim dhe pa u kufizuar të detyrimet e përcaktuara në seksionin 2.05 të Kushteve Standarde, Marrësi do të garantojë nëpërmjet Sekretariatit Kombëtar EITI, që:

a) Të gjitha të dhënat e evidentuara të shpenzimeve të projektit të mbajtura për 7 vjet e 6



muaj pas datës së mbylljes, përfshijnë këtë Marrëveshje, të gjithë axhendën, si dhe amendamentet; ii) raportin financiar dhe narrativ të progresit të Marrësit të dërguar Bankës Botërore; iii) informacionin financiar të Marrësit në lidhje me grantin, duke përfshirë raporte auditimi, fatura dhe të dhënat e pagesave; dokumentacionin (duke përfshirë nën-marrëveshje, dosjet e prokurimit, kontratat, urdhër pagesat); dhe v) të dhënat korresponduese të referuara seksionit 3.04 të kushteve standarde; dhe

b) Përfaqësuesit e Bankës Botërore, janë: i) në gjendje të kontrollojnë të gjitha të dhënat e referuara paragrafit të mësipërm “a”: ii) t’u ofrohet i gjithë informacioni në lidhje me të dhëna të tilla provuese, siç mund të kërkoher herë pas here në mënyrë të arsyeshme; dhe iii) në gjendje të rihapin të dhëna dhe informacione të tilla për Donatorin.

2.06 Monitorimi, raportimi dhe vlerësimi i projektit: a) Marrësi, nëpërmjet Sekretariatit Kombëtar EITI, do të monitorojë dhe vlerësojë progresin e Projektit dhe do të përgatitë Raportet e Projektit në përputhje me dispozitat e seksionit 2.06 të Kushteve Standarde dhe mbi bazën e treguesve të pranueshëm për Bankën Botërore. Çdo raport projekti do të mbulojë periudhën e një semestri kalendarik dhe do t’i dërgohet Bankës Botërore jo më vonë se një muaj pas përfundimit të periudhës së mbuluar nga raporti në fjalë.

b) Marrësi, nëpërmjet Sekretariatit Kombëtar EITI, do të përgatitë raportin përfundimtar në përputhje me dispozitat e seksionit 2.06 të Kushteve Standarde. Raporti përfundimtar duhet t’i dërgohet Bankës Botërore jo më vonë se gjashtë muaj pas datës së mbylljes.

2.07 Menaxhimi financiar: a) Marrësi, nëpërmjet Sekretariatit Kombëtar EITI, do të garantojë që një sistem menaxhimi financiar të mbahet në përputhje me dispozitat e seksionit 2.07 të kushteve standarde.

b) Marrësi, nëpërmjet Sekretariatit Kombëtar EITI, do të garantojë që raportet e ndërmjetme financiare të paaudituar për projektin të jenë përgatitur dhe t’i jenë dhënë Bankës Botërore si pjesë e raportit të projektit jo më vonë se 45 ditë pas përfundimit të çdo semestri kalendarik që mbulon semestrin, në formë dhe përmbajtje të pranueshme nga Banka Botërore.

c) Marrësi, nëpërmjet Sekretariatit Kombëtar EITI, do të disponojë pasqyrat financiare të

audituar në përputhje me dispozitat e seksionit 2.07/b të Kushteve Standarde. Ky auditim i pasqyrave financiare duhet të mbulojë të gjithë periudhën e një viti fiskal për Marrësin. Pasqyrat financiare të audituar për këtë periudhë do t’i dërgohen Bankës Botërore jo më vonë se gjashtë muaj pas përfundimit të kësaj periudhe.

2.08 Prokurimi

a) Të përgjithshme. Të gjitha mallrat dhe shërbimet e konsulencës që kërkoher për projektin dhe që duhet të financohen nga shumat e Grantit do të prokurohen në përputhje me kërkesat e përcaktuara ose të përmendura në:

i) Seksionin I të “udhëzimeve: prokurimi i mallrave, i punimeve dhe i shërbimeve jokonsulente, sipas huave të ibrd-së dhe kredive dhe granteve të IDA-së nga Huamarrësit e Bankës Botërore”, të muajit janar 2011 (të rishikuara në korrik 2014) (Udhëzimet e prokurimit), në rastin e mallrave dhe shërbimeve jokonsulente; dhe

ii) Seksionet I dhe IV të “Udhëzimet: Përzgjedhja dhe punësimi i konsulentëve nën kreditë e IBRD-së dhe kredive dhe granteve të IDA-s nga Huamarrësit e Bankës Botërore, janar 2011 (të rishikuara në korrik 2014) (udhëzimet e konsulentit) në rastin e shërbimeve të konsulentëve;

b) Përkufizime. Termat me germa kapitale, të përdorur në paragrafët e mëposhtëm të këtij seksioni, për të përshkruar metoda të veçanta prokurimi ose metoda rishikimi nga Banka Botërore për kontrata të veçanta, i referohen metodës përkatëse të përshkruar në seksionet II dhe III të udhëzimeve të prokurimit ose seksioneve II, III, IV dhe V të udhëzimeve për konsulentët, sipas rastit.

d) Metodat e veçanta të prokurimit të mallrave

i) ndryshe nga se parashikohen në nënparagrafin “ii”, si më poshtë, mallrat dhe shërbimet e konsulentëve do të prokurohen nën një kontratë të hartuar mbi bazën e Ofertimit Konkurrues Ndërkombëtar.

ii) Metodat në vijim, përveç nga Ofertimi Konkurrues Ndërkombëtar, mund të përdoren për prokurimin e mallrave dhe shërbimeve jokonsultative për ato kontrata që janë të specifikuar në Planin e Prokurimit: A) Ofertimi Konkurrues Kombëtar në bazë të dispozitave shitesë të paragrafit; iii) të këtij seksioni; B) Blerjet^{*}; dhe C) kontraktimi i drejtpërdrejtë;



iii) Ndryshime në procedurat e Ofertimit Konkurrues kombëtar të Huamarrësit.

Procedurat e Ofertimit Konkurrues Kombëtar (OKK) do të bazohen në procedurat e tenderit të hapur, siç parashikohet në ligjin për prokurimin publik (PPL) të Shqipërisë (ligji nr. 9643, i datës 20 nëntor 2006, i ndryshuar), megjithatë me kusht që kjo procedurë t'u nënshtrohet dispozitave të nenit 1 dhe paragrafëve 3.3 dhe 3.4 të udhëzimeve të prokurimeve dhe dispozitave të mëposhtme shtesë:

a) Procedurat e “Tenderit të hapur”, siç përcaktohen nga PPL-ja e Shqipërisë, do të zbatohen për të gjitha kontratat e financuara nga Banka;

b) Ofruesit e huaj nuk duhet të përjashtohen nga ofertimi dhe asnjë lloj preference nuk duhet t'u jepet ofertuesve kombëtarë gjatë procesit të ofertimit. Ndërmarrjet shtetërore në Shqipëri do të lejohen në ofertim vetëm nëse janë të pavarura nga pikëpamja ligjore dhe financiare dhe do të operojnë sipas së drejtës tregtare të Marrësit. Regjistrimi nuk duhet të përdoret për të vlerësuar kualifikimet e ofertuesve;

c) Ofertat do të hapen publikisht vetëm në një vend, menjëherë pas përfundimit të afatit për dorëzimin e ofertave në prani të përfaqësuesve që vendosin të marrin pjesë;

d) Subjektet ofertuese do të përdorin dokumente tip ofertimi, siç miratohen nga Banka;

e) Në rast të ofertave me çmime më të larta në krahasim me llogaritjen zyrtare, asnjë prej ofertave nuk do të refuzohet pa marrëveshje paraprake nga Banka;

f) Procedura e një zarfi të vetëm do të përdoret për dorëzimin e ofertave;

g) Kualifikimi i mëposhtëm do të kryhet vetëm për ofertuesit me vlerësimin më të ulët; asnjë ofertë nuk do të refuzohet në kohën e hapjes së ofertave në bazë të kualifikimeve;

h) Ofertuesit e formës së sipërmarrjes së përbashkët do të konsiderohen përgjegjës individualisht dhe bashkërisht;

i) Para se të refuzohen të gjitha ofertat dhe të kërkohen oferta të reja, duhet të merret miratimi paraprak i Bankës;

j) Kontrata do t'i jepet ofruesit me vlerë më të ulët, kryesisht përgjegjës, i cili është konstatuar të jetë i kualifikuar për të përmbushur detyrën në përputhje me kriteret e vlerësimit të paracaktuara dhe të njoftuara paraprakisht;

k) Negociatat pas ofertimit nuk do të lejohen me ofertuesit me vlerësim më të ulët ose me ndonjë ofertues tjetër;

l) Kontratat afatgjata (më shumë se 18 muaj) do të përmbajnë dispozitat përkatëse për përshtatjen e çmimit të pranueshëm nga Banka;

m) Garancitë e ofertës dhe të kontratës do të jenë në formën e përfshirë në dokumentet e tenderimit të referuara, “d” si më sipër. Garancia e ofertës do të jetë e vlefshme për 28 ditë (njëzetë e tetë) pas periudhës fillestare të vlefshmërisë së ofertës ose pas çdo periudhe shtyrjeje afati në rastet e kërkuara. Asnjë parapagim nuk do të kryhet pa një garanci të përshtatshme për parapagim;

n) Dokumentet e ofertimit dhe kontrata që konsiderohen të pranueshme nga Banka do të përmbajnë dispozita që përcaktojnë politikat e Bankës për të sanksionuar firma ose individë të cilët zbulohen të jenë përfshirë në aktivitete korrupsioni ose mashtrimi, siç përcaktohet në udhëzimet e prokurimit;

o) Në përputhje me udhëzuesit e prokurimit, çdo dokument ofertimi dhe kontrate i financiar nga shumat e parapagimit do të garantojë se ofertuesit, furnizuesit, kontraktuesit dhe nënkontraktuesit, agentët, personeli, konsulentët, ofertuesit e shërbimeve ose furnizuesit e tyre do t'i lejojnë Bankës inspektimin e llogarive, regjistrave dhe dokumenteve të tjera që lidhen me dhënien e ofertave dhe përmbushjen e kontratës dhe të lejojnë në masën që ato të auditohen nga audituesit e caktuar nga Banka. Pa u kufizuar të parashikimet e përcaktuara në paragrafin 1.16/a/v/bb të udhëzuesit të prokurimeve që vepron me qëllimin për të parandaluar materialisht ushtrimin e inspektimit të Bankës dhe të drejtave të auditit të ofruara në udhëzimet e prokurimit duhet të përbëjë një praktikë penguese siç përcaktohet në udhëzimet e prokurimit.

a) Metoda të veçanta të prokurimit të shërbimeve të konsulentëve

i) Përveç rasteve kur parashikohet në pikën “ii” si më poshtë, shërbimet e konsulencës do të prokurohen sipas kontratave të dhëna bazuar në zgjedhjen mbi bazë cilësie dhe kostoje;

ii) Metodatat e mëposhtme përveç përzgjedhjes me bazë cilësinë dhe koston, mund të përdoren për prokurimin e shërbimeve të konsulentëve, për ato detyra që janë specifikuar në planin e prokurimit:
A) cilësia dhe përzgjedhja e bazuar në kosto; B)



Përzgjedhja sipas buxhetit fiks; C) përzgjedhja me koston më të ulët; D) përzgjedhja e bazuar në kualifikimet e konsulentëve; E) përzgjedhja me burim të vetëm të firmave; dhe F) përzgjedhja e konsulentëve individualë; dhe G) procedurat e burimeve të vetme për përzgjedhjen e konsulentëve individualë.

e) Rishikimi nga Banka Botërore i vendimeve të prokurimit

Plani i prokurimit do të vendoset për ato kontrata që duhet t'i nënshtrohen rishikimit paraprak nga Banka Botërore. Të gjitha kontratat e tjera do t'i nënshtrohen shqyrtimit të mëposhtëm nga Banka Botërore.

f) Mbajtja e dokumenteve. Pavarësisht parashikimeve në paragrafin 2/j dhe 5, të shtojcës 1, të udhëzimeve të prokurimit, dhe paragrafit 2/k dhe 5 të shtojcës 1 të udhëzimeve të konsulentit, Marrësi: i) duhet të mbajë të gjithë dokumentacionin në lidhje me çdo kontratë siç është përshkruar në paragrafin e lartpërmendur për të paktën shtatë vjet dhe gjashtë muaj pas mbylljes së datës të përcaktuar në seksionin 3.03 të kësaj Marrëveshjeje; ii) duhet të pajisë Bankën Botërore me këtë dokumentacion në çdo kohë sipas kërkesës; dhe iii) duke autorizuar në këtë mënyrë Bankën Botërore për ta rihapur këtë dokumentacion për donatorët.

Neni 3

Tërheqja e parapagimit

3.01 Shpenzimet e pranueshme. Përfutuesi mund të tërheqë vlerën e parapagimit, në përputhje me dispozitat e: a) kushteve standarde; b) këtij paragrafi; dhe c) udhëzimeve të tilla shtesë që Banka Botërore mund t'i specifikojë Marrësit (duke përfshirë "Udhëzuesit e disbursimit për projektet e Bankës Botërore" të muajit maj 2006, të rishikuara herë pas here nga Banka Botërore dhe të bëra të zbatueshme për këtë marrëveshje në pajtim me këto udhëzime), për financimin e shpenzimeve të lejueshme, të përcaktuara në tabelën e mëposhtme. Tabela specifikon kategoritë e shpenzimeve të lejueshme që mund të financohen nga të ardhurat e grantit (kategoria), alokimet e shumave të grantit për çdo kategori dhe përqindjen e shpenzimeve për t'u financuar për shpenzimet e lejuara në çdo kategori.

Kategoria	Vlera e grantit të alokuar (e shprehur në USD)	Përqindja e shpenzimeve për t'u financuar (përfshirja e taksave)
1) Mallra, shërbime konsulentësh, trajnime dhe kosto operative të projektit	400,000	100%
SHUMA TOTALE	400,000	

3.02 Kushtet e tërheqjes. Pavarësisht nga dispozitat e seksionit 3.01 të kësaj marrëveshjeje, asnjë tërheqje nuk do të bëhet për pagesat e kryera para datës së nënshkrimit të kësaj marrëveshjeje, përveç rasteve të tërheqjeve të shumave që nuk kalojnë shumën totale 40,000 \$ të barasvlershme, të cilat mund të bëhen për pagesat e kryera para kësaj date, por në apo pas datës 12 (dymbëdhjetë) muaj para datës së marrëveshjes, për shpenzime të lejuara të projektit.

3.03 Periudha e tërheqjes. Data e mbylljes e përmendur në seksionin 3.06/c të kushteve standarde është 31 dhjetor 2017.

Neni 4

Përfaqësuesi i përfutuesit, adresat

4.01 Përfaqësuesi i përfutuesit. Përfaqësuesi i përfutuesit i përmendur në seksionin 7.02 të kushteve standarde është ministri i Financave.

4.02 Adresa e përfutuesit. Adresa e përfutuesit e përmendur në seksionin 7.01 të kushteve standarde është:

Ministria e Financave
Bulevardi "Dëshmorët e Kombit",
Nr. 3, Tiranë, Shqipëri
Faks: + 355 4 2228405

4.03 Adresa e Bankës Botërore. Adresa e Bankës Botërore e përmendur në seksionin 7.01 të kushteve standarde është:

Banka Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim
1818 H Street, N.W.
Washington, D.C. 20433
United States of America
Faks: 1- 202-477-6391

**BANKA BOTËRORE**

IBRD IDA/GRUPI I BANKËS BOTËRORE

Sh.t. Arben Ahmetaj

Ministër i Financave

Ministria e Financave

Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”

Tiranë, Shqipëri

26 shkurt

Granti nr. TF0A1769***Mbështetje për projektin nisma për
transparencë në industrisë nxjerrëse, në
procesin si vend zbatues*****Udhëzime plotësuese: Letra e disursimit**

Shkëlqesi,

I referohemi letrës së marrëveshjes (Marrëveshja) ndërmjet Republikës së Shqipërisë (Marrësi) dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim (Banka Botërore), në cilësinë e administratorit të fondeve të grantit të dhënë nga Australia, Belgjika, Kanadaja, Danimarka, Bashkimi Evropian, e përfaqësuar nga Komisioni Evropian, Finlanda, Franca, Gjermania, Japonia, Holanda, Norvegjia, Spanja, Zvicra, Mbretëria e Bashkuar dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës (donatorët), në bazë të Fondit të Besimit me Shumë Donatorë për Shqipërinë për Iniciativën për Transparencë të Industrisë Nxjerrëse (EITI), mbështetje për zbatimin e projektit të lartpërmendur të datës 26 shkurt 2016. Marrëveshja parashikon se Banka Botërore mund të nxjerrë udhëzime shtesë në lidhje me tërheqjen e shumave të grantit nr. TF0A1769 (grantit). Kjo letër (letër disbursimi) e rishikuar herë pas here përbën udhëzime shtesë.

Udhëzimet e *disbursimit të Bankës Botërore për projektet* bashkëlidhur, të datës 1 maj 2006 (udhëzimet e disbursimit) (shtojca 1) janë pjesë integrale e letrës së disbursimit. Mënyra në të cilën dispozitat në udhëzimet e disbursimit zbatohen për grantin, përcaktohet më poshtë. Seksionet dhe nënseksionet në thonjëza më poshtë u referohen seksioneve dhe nënseksioneve përkatëse në udhëzimet e disbursimit dhe, nëse nuk përcaktohet ndryshe në këtë letër, termat me germa kapitale të përdorur kanë kuptimet e dhëna atyre në udhëzimet e disbursimit.

I. Masat e disbursimit

i) *Metodat e disbursimit (seksioni 2)*. Për grantin mund të përdoren metodat e mëposhtme të disbursimit:

- rimbursimi;

- pagesa e drejtpërdrejtë.

ii) *Data e afatit të fundit të disbursimit (nënseksioni 3.7)*. Data e afatit të fundit të disbursimit është 4 muaj pas datës së mbylljes të përcaktuar në Marrëveshjen e Grantit. Çdo ndryshim në këtë datë do të njoftohet nga Banka Botërore.

iii) *Kushtet e disbursimit (nënseksioni 3.8)*. Ju lutem referojuni kushtit të disbursimit në seksionin 3.02 në marrëveshjen e grantit.

II. Tërheqja e parapagimit*i) Nënshkrimet e autorizuar (nënseksioni 3.1)*

Një letër, si formulari bashkëlidhur (shtojca 2), duhet t'i dërgohet Bankës Botërore në adresën e caktuar si më poshtë, duke dhënë emrin (emrat) dhe modelin (modelet) e nënshkrimeve të zyrtarit (zyrtarëve) të autorizuar për të dorëzuar aplikimin:

Banka Botërore

1818 H Street, N.W.

Washington, D.C. 20433

United States of America

Faks: 1- 202-477-6391

Në vëmendje: Drejtori i vendit

ii) *Aplikimet (nënseksioni 3.2–3.3)* ju lutem jepni aplikimin e përfunduar për tërheqjen, së bashku me dokumentet mbështetëse nëpërmjet lidhjes së klientit të Bankës Botërore, portalit të internetit, duke ndjekur udhëzimet e dërgimit elektronik. Në rast se Marrësi nuk ka akses në internet, Banka Botërore mund t'i lejojë dorëzimin e aplikimeve për tërheqje, së bashku me dokumentacionin mbështetës, në përputhje me nënseksionin 3.3, në adresën e mëposhtme.

Banka Botërore

Radnicka cesta 80/IX

10000 Zagreb, Kroaci

Në vëmendje të: Departamentit të huave

iii) *Dërgimi elektronik (nënseksioni 3.4)* Banka Botërore mund t'i lejojë Marrësit t'i dorëzojë shoqërisë aplikuese në mënyrë elektronike (me dokumentet mbështetëse) përmes lidhjes së klientit të shoqërisë, portalit të internetit. Opsioni për dorëzimin e aplikimit ndaj Bankës Botërore në mënyrë elektronike mund të realizohet, nëse: a) marrësi ka paracaktuar në shkrim, në përputhje me rregullat e nënparagrafit “i” të këtij seksioni, zyrtarët e tij, të cilët janë të autorizuar të nënshkruajnë dhe të dërgojnë aplikimin dhe të marrin aparatura për identifikim të sigurt SIDC nga Banka Botërore për qëllimin e dërgimit të



aplikimeve në mënyrë elektronike; dhe b) zyrtarë të tillë të caktuar nga Marrësi janë regjistruar si përdorues të lidhjes me klientët. Nëse Banka Botërore bie dakord, Banka Botërore do t'i ofrojë Marrësit SIDC për zyrtarët e caktuar. Në vijim të kësaj procedure, zyrtarët e caktuar do të dorëzojnë në mënyrë elektronike, duke plotësuar formatin 2380, i cili është i aksesueshëm përmes lidhjes së Klientit (<https://clientconnection.worldbank.org>).

Marrësi mund të vazhdojë të shfrytëzojë alternativën për përgatitjen dhe dorëzimin e aplikimit në formë letre. Banka Botërore ka të drejtën në fshehtësi të plotë që të mos lejojë në raste të veçanta dorëzimin e përkohshëm apo të përhershëm të aplikimit të marrësit në mënyrë elektronike.

iv) Afatet dhe kushtet e përdorimit të SIDC-së në procesin e aplikimit

Me përcaktimin e zyrtarëve për të pranuar SIDC-në dhe zgjedhjen e dorëzimit të aplikimit në mënyrë elektronike, marrësi konfirmon përmes letrës së autorizuar të firmosur, pëlqimin e tij për të: rënë dakord me kushtet e pranimi të përdorimit të aparaturave për identifikim të sigurt në lidhje me përdorimin e mjeteve elektronike për të përpunuar aplikimin dhe dokumentacionin mbështetës (Kushtet e përdorimit të SIDC-së) të dhëna në bashkë-lidhjen 3; dhe b) për të paraqitur kushtet për Përdorimin e SIDC-së për secilin zyrtar dhe për të marrë masa që zyrtarët të pajtohen me kushtet.

v) Vlera minimale e aplikimit (nënseksioni 3.5). Vlera minimale e aplikimeve për rimbursim dhe pagesa e drejtpërdrejtë është 5000 dollarë amerikanë.

vi) Paradhëniet (seksioni 5 dhe 6) Për arsye të nënseksionit 5.2. dhe udhëzimeve të disbursimit shuma paradhënie e shumave të grantit në llogarinë e caktuar nuk është aktualisht metodë disbursimi, aktualisht e vlefshme sipas këtij granti. Ju lutem dërgoni aplikimet vetëm në mbështetje të metodave të disbursimit të renditura në nënseksionin I/i të kësaj letre.

III. Raportimi për përdorimin e shumave të grantit

i) Dokumentacioni mbështetës (seksioni 4). Dokumentacioni mbështetës duhet të jepet me çdo kërkesë për tërheqje, siç përcaktohet më poshtë:

- Për kërkesat për rimbursim;
- pasqyra e shpenzimeve në formatin bashkë-lidhur (shtojca 4);

- të dhënat që evidentojnë shpenzimet e pranueshme (për shembull, kopje të faturave, fatura të furnizuesve) për pagesat për konsulentët individualë kundrejt kontratave me vlerë 50,000\$ ose më shumë; për firmat e konsulencës kundrejt kontratave me vlerë 100,000 \$ ose më shumë;

- lista e pagesave kundrejt kontratave që i nënshtrohen rishikimit paraprak të Bankës Botërore, në formatin bashkëngjitur (shtojca 5);

- për kërkesën për pagesë të drejtpërdrejtë: të dhënat që evidentojnë shpenzimet e pranueshme, për shembull kopje të faturave, fatura të furnizuesve.

IV. Informacion tjetër i rëndësishëm

Për informacione shitesë mbi masat e disbursimit, ju lutem referojuni manualit të disbursimit të vënë në dispozicion në faqen publike të internetit të Bankës <https://www.worldbank.org> dhe faqes së saj të sigurt të internetit “Lidhja e klientit” <https://clientconnection.worldbank.org>. Kopjet e printuara vihen në dispozicion sipas kërkesës.

Nga faqja e internetit e “Lidhjes së klientit”, do të jeni në gjendje të shkarkoni aplikime, të monitoroni në kohë reale gjendjen e përafërt të grantit dhe të nxirrni informacione në lidhje me politikat, financimin dhe prokurimin.

Nëse ende nuk e keni bërë këtë, Banka rekomandon që të regjistroheni si përdorues i faqes së internetit të “Lidhjes së klientit” (<https://clientconnection.worldbank.org>). Nga kjo faqe interneti do të shkarkoni aplikime, do të monitoroni në kohë reale gjendjen e përafërt të grantit dhe do të nxirrni informacione në lidhje me politikat, financimin dhe prokurimin. Të gjithë zyrtarëve të përfituesit të autorizuar për të nënshkruar dhe dorëzuar aplikime me mjete elektronike u kërkohet të regjistrohen në lidhjen e klientit përpara kryerjes së dorëzimit elektronik. Për më shumë informacion rreth faqes së internetit dhe masave të regjistrimit, ju lutem kontaktoni Bankën me e-mail në clientconnection@worldbank.org.

Nëse keni pyetje në lidhje me sa më sipër, ju lutem kontaktoni LOA-TF në adresën loa-tf@worldbank.org, duke përdorur numrin e fondit të mirëbesimit si referencë.



Me respekt,
BANKA NDËRKOMBËTARE PËR
RINDËRTIM DHE ZHVILLIM

Nga

Tahseen Sayed
Menaxhere vendi

Zyra e Bankës Botërore Tiranë, Shqipëri

Bashkëlidhur:

1. Udhëzimet e Bankës Botërore për disburimet e projekteve, datë 1 maj 2006;
2. Formulari për nënshkrimet e autorizuara;
3. Udhëzimet për përdorimin e aparaturave për identifikimin e sigurt në lidhje me përdorimin e mjeteve elektronike për përpunimin e aplikimeve dhe dokumentacionit mbështetës, datë 1 mars 2013;
4. Formulari i pasqyrës së shpenzimeve;
5. Formulari i pagesave kundrejt kontratave të subjekteve që i nënshtrohen rishikimit paraprak të bankës botërore.

SHTOJCA 2

[koka e letrës]
Ministria e Financave
[adresa postare]
[qyteti] [vendi]

[DATË]

Banka Botërore
1818 H Street, N.W.
Washington, D.C. 20433
United States of America
Faks: 1- 202-477-6391
Në vëmendje të: [Drejtori i vendit]
E nderuar [Drejtori i vendit]

Granti nr. TF0A1769

***Mbështetje për projektin nisma për
transparencë në industrisë nxjerrëse, në
procesin si vend zbatues***

I referohemi letrës së marrëveshjes (Marrëveshja) [Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim/Shoqata Ndërkombëtare për Zhvillim] (Banka Botërore) që vepron si [administratore e fondeve e fondit të] besimit me shumë donatorë dhe [emri i marrësit] (Marrësi), i datës _____, që ofron grantin e mësipërm. Për qëllimet e seksionit 3.04/b të kushteve standarde, të përcaktuara në Marrëveshje, çdokush prej

personave, nënshkrimet model [1një] të vërtetuara të të cilëve shfaqen më poshtë, autorizohet në emër të përfituesit të nënshkruarë aplikimet për tërheqje dhe aplikimet për një angazhim të veçantë financiar sipas këtij granti.

Për qëllim të dorëzimit të aplikimeve pranë Bankës Botërore, [2secili] prej personave, modelet e vërtetuara të të cilëve shfaqen më poshtë, autorizohet në emër të Marrësit [3individualisht] [4bashkërisht] që të dorëzojë aplikime dhe të dhëna mbështetëse në bazë të termave dhe kushteve të përcaktuar nga Banka Botërore.

[5Kjo konfirmon se Marrësi autorizon këta persona të pranojnë pajisjet e posaçme SIDC dhe të dorëzojnë aplikimet dhe dokumentet mbështetëse Bankës Botërore me mjete elektronike. Duke pranuar plotësisht se Banka Botërore do të bazohet në këto përfaqësime dhe garanci, duke përfshirë pa kufizim, përfaqësimet dhe garancitë në përmbajtje të termave dhe kushteve të përdorimit të aparaturave të identifikimit të sigurt në lidhje me përdorimin e mjeteve elektronike për përpunimin e aplikimeve dhe dokumentacionit mbështetës (termat dhe kushtet e përdorimit të pajisjeve të posaçme), përfituesi përfaqëson dhe i garanton Bankës Botërore se ai do t'i dorëzojë secilit prej këtyre personave një kopje të termave dhe kushteve të përdorimit të pajisjeve të posaçme dhe do të marrë masa që këta persona t'i respektojnë këta terma dhe kushte.

¹ Udhëzime për marrësin për dorëzimin e letrës Bankës Botërore: Përcaktoni nëse më shumë se një person duhet të nënshkruajë aplikimin dhe sa pozicione të tilla, dhe nëse ka ndonjë prag. *Ju lutem fshini këtë shënim fundor në letrën përfundimtare që do t'i dërgohet Bankës Botërore.*

² Udhëzime për marrësin: Përcaktoni nëse më shumë se një person duhet të nënshkruajë; nëse nuk është e zbatueshme, ju lutem fshijeni. *Ju lutem fshini këtë shënim fundor në letrën përfundimtare që do t'i dërgohet Bankës Botërore.*

³ Udhëzime për Marrësin: Ju lutem përdorni këtë kllapë nëse një nga personat e autorizuar do të nënshkruajë; nëse nuk është e zbatueshme ju lutem fshijeni. *Ju lutem fshini këtë shënim fundor në letrën përfundimtare që do t'i dërgohet Bankës Botërore.*

⁴ Udhëzime për marrësin: Ju lutem përdorni këtë kllapë vetëm nëse disa persona të autorizuar do të nënshkruajnë Aplikimin; nëse nuk është e zbatueshme, ju lutem fshijeni. *Ju lutem fshini këtë shënim fundor në letrën përfundimtare që do t'i dërgohet Bankës Botërore.*

⁵ Udhëzime për marrësin: Përdorni këtë paragraf nëse Marrësi dëshiron të autorizojë personat e autorizuar për të pranuar pajisjet e veçanta dhe për t'i dorëzuar aplikimet në mënyrë elektronike. Nëse nuk është e zbatueshme, ju lutem fshijeni. *Ju lutem fshini këtë shënim fundor në letrën përfundimtare që do t'i dërgohet Bankës Botërore.*



Ky autorizim zëvendëson çdo autorizim aktualisht në të dhënat e Bankës në lidhje me këtë Marrëveshje.

[emri], [pozicioni] nënshkrimi model: _____

[emri], [pozicioni] nënshkrimi model: _____

[emri], [pozicioni] nënshkrimi model: _____

Me respekt
/nënshkrimi/

[Pozicioni]

SHTOJCA 3

**Termat dhe kushtet e përdorimit të
aparaturave për identifikimin e sigurt
në lidhje me përdorimin e mjeteve
elektronike
për përpunimin e aplikimeve dhe
dokumentacionit mbështetës**

1 mars 2013

Banka Botërore (Banka)⁶ do të ofrojë aparaturë për identifikim të sigurt (SIDC) për të lejuar Huamarrësin⁷ të dorëzojë aplikime për tërheqje dhe aplikime për angazhime të veçanta financiare sipas Marrëveshjes/eve dhe dokumentacion mbështetës (këto aplikime dhe dokumentacioni mbështetës bashkërisht të përmendura në këta terma dhe kushte të përdorimit si aplikime) për Bankën në formë elektronike, në bazë të termave dhe kushteve të përcaktuar në të.

A. Identifikimi i përdoruesve

1. Huamarrësit do t'i kërkohej të identifikojë në një letër të plotësuar të nënshkruesit të autorizuar (ASL), të dorëzuar dhe të marrë sipas rregullave nga Banka, çdo person që do të autorizohet të dorëzojë aplikime. Banka do t'i ofrojë pajisje të posaçme çdo personi të identifikuar në ASL (nënshkruesi), siç parashikohet më poshtë. Gjithashtu, Huamarrësi do të njoftojë menjëherë Bankën nëse një nënshkrues nuk është më i autorizuar nga Huamarrësi që të veprojë si nënshkrues.

2. Çdo nënshkrues duhet të regjistrohet si përdorues në faqen e internetit të lidhjes së klientit të Bankës (CC) (<https://clientconnection.worldbank.org>) përpara dorëzimit të pajisjeve të posaçme.

Regjistrimi në CC do të kërkojë që nënshkruesi të krijojë një fjalëkalim CC (fjalëkalimi CC). Nënshkruesi nuk ia zbulon asnjë personi fjalëkalimin e tij/të saj CC ose nuk e ruan ose regjistron fjalëkalimin CC në formë me shkrim ose në ndonjë formë tjetër. Pas regjistrimit si përdorues CC, nënshkruesit do t'i jepet një emër unik identifikues llogarie.

B. Siglimi i SIDC-së

1. Përpara se SIDC-ja të siglohet nga një nënshkrues, nënshkruesi duhet të pranojë se ka lexuar, kuptuar dhe rënë dakord të ndjekë termat dhe kushtet e përdorimit.

2. Kur duhet të përdoret një pajisje e posaçme, me marrjen e menjëhershme të pajisjes së posaçme. Nënshkruesi duhet të ketë akses në CC duke përdorur emrin e llogarisë dhe fjalëkalimin e tij/saj dhe të vendosë një numër identifikimi personal (PIN) për t'u përdorur në lidhje me përdorimin e pajisjes së posaçme, pas së cilës pajisja e posaçme do të lejohet të përdoret nga nënshkruesi, veçanërisht për qëllime të nxjerrjes së aplikimeve. Kur duhet përdorur një pajisje softi, nënshkruesi do të hyjë në CC duke përdorur emrin e llogarisë dhe fjalëkalimin e tij/saj dhe do të vendosë një numër identifikimi personal (PIN) për t'u përdorur në lidhje me përdorimin e të pajisjes së tij/saj të softit, pas të cilës pajisja e posaçme do të lejohet të përdoret nga nënshkruesi, veçanërisht për qëllime të nxjerrjes së aplikimeve. Sapo SIDC-ja të fillojë të funksionojë, nënshkruesi, do të jetë një "Përdorues SIDC". Banka do të ruajë në bazën e vet të të dhënave një llogari përdoruesi (Llogari) për çdo përdorues SIDC për qëllime të menaxhimit të SIDC-së të përdoruesit të SIDC-së. Huamarrësi dhe përdoruesi i SIDC-së nuk do të mund të hyjnë në llogari.

3. Përpara përdorimit të parë të SIDC-së nga përdoruesi i SIDC-së, Huamarrësi duhet të garantojë që përdoruesi i SIDC-së ka marrë materialet e trajnimit të siguruar nga Banka në përdorim të SIDC-së.

C. Përdorimi i SIDC-së

1. SIDC-ja kufizohet rreptësisht të përdoret në lëshimin e aplikimeve nga përdoruesi i SIDC-së, sipas mënyrës së përshkruar nga Banka në Marrëveshjen/et dhe në këta terma dhe kushte. Ndalohej çdo përdorim tjetër i pajisjes së posaçme.

2. Banka nuk merr përsipër asnjë lloj përgjegjësie ose detyrimi për ndonjë keqpërdorim

⁶ "Banka" përfshin IBRD-në dhe IDA-në.

⁷ "Huamarrësi" përfshin Huamarrësin e një huaje të IBRD-së, kredinë e IDA-së ose huan për shërbimin e përgatitjes së projektit dhe përfituesin e një granti.



të pajisjes së posaçme nga përdoruesi i pajisjes së posaçme, përfaqësues të tjerë të huamarrësit ose palë të treta.

3. Huamarrësi merr përsipër të garantojë dhe përfaqësojë, dhe garantojë Bankës (ndërsa ky përfaqësim dhe kjo garanci mbështetet shprehimisht nga Banka në dorëzimin e një pajisjeje të posaçme për çdo përdorues të pajisjes së posaçme) që çdo përdorues i pajisjes së posaçme SIDC i siguar, kupton dhe respekton këta terma dhe kushte përdorimi, duke përfshirë pa kufizim sa më poshtë:

4. Sigurimi

4.1 Përdoruesi i pajisjes së posaçme nuk i zbulon asnjë personi PIN-in e tij/të saj ose nuk ruan apo regjistron PIN-in në një formë me shkrim ose në ndonjë formë tjetër.

4.2 Përdoruesi i pajisjes së posaçme nuk lejon asnjë person tjetër të shfrytëzojë një pajisje të posaçme për t'i dorëzuar Bankës një aplikim.

4.3 Kur nuk përdor sistemin, përdoruesi i pajisjes së posaçme duhet të dalë gjithmonë nga CC-ja. Mosdalja në mënyrën e duhur mund të krijojë një rrugë të pambrojtur në sistem.

4.4 Nëse përdoruesi i pajisjes së posaçme çmon se një palë e tretë ka mësuar PIN-in e tij/të saj, ose ka humbur pajisjen e posaçme të tij/saj, ai/ajo do të njoftojë menjëherë në adresën clientconnection@worldbank.org

4.5 Huamarrësi do të njoftojë menjëherë Bankën në adresën clientconnection@worldbank.org në lidhje me çdo pajisje të posaçme të humbur, të vjedhur ose të cenuar, dhe merr hapa të tjerë të arsyeshëm që këto pajisje të posaçme të çaktivizohen menjëherë.

5. Rezervimi i së drejtës për çaktivizimin e pajisjes së posaçme

5.1 Huamarrësi rezervon të drejtën për të anuluar autorizimin e një përdoruesi të pajisjes së posaçme, për të përdorur një pajisje të posaçme për çdolloj arsyeje.

5.2 Banka rezervon të drejtën, në fshehtësi të plotë, për të çaktivizuar përkohësisht ose në mënyrë të përhershme një pajisje të posaçme SIDC, për të çaktivizuar një llogari të përdoruesit të pajisjes së posaçme ose të dyja.

6. Menaxhimi i pajisjeve të posaçme

6.1 Pajisjet e posaçme do të mbeten pronë e Bankës.

6.2 Përdorimi i pajisjeve të posaçme kufizohet rreptësisht në përdorimin për dorëzimin e aplikimeve nga përdoruesi i pajisjes së posaçme në mënyrën e përcaktuar nga Banka.

6.3 Pajisjet e posaçme përmbajnë instrumentin sensitiv dhe të sofistikuar dhe, rrjedhimisht, duhet të trajtohen me kujdesin e duhur dhe nuk duhet të zhyten në lëngje, nuk duhet të ekspozohen në temperatura ekstreme, nuk duhet të shtypen ose përkulen. Gjithashtu, pajisjet e posaçme duhet të mbahen më shumë se 5 (pesë) cm nga aparaturat që lëshojnë rrezatim elektromagnetik (EMR), si për shembull: telefona celularë, PDA për mundësimin e telefonave, *smart phones* dhe aparate të tjera të ngjashme. Pajisjet e posaçme duhet të mbahen dhe ruhen të ndara nga ndonjë aparat EMR. Në rreze të ngushtë (më pak se 5 cm), këto aparate mund të prodhojnë nivele të larta EMR-je që mund të shkaktojnë interferenca në funksionimin e duhur të pajisjeve elektronike, duke përfshirë pajisjen e posaçme.

6.4 Pa u shmangur nga këta terma dhe kushte përdorimi, udhëzime të tjera teknike mbi përdorimin dhe kujdesin e duhur, pajisjet e posaçme janë të disponueshme në adresën <http://www.rsa.com>.

7. Zëvendësimi

7.1 Pajisjet e posaçme të humbura, të dëmtuara, të cenuara (në lidhje me pikat 4.5 më lart) ose të shkatërruara do të zëvendësohen me shpenzime të Huamarrësit.

7.2 Banka rezervon të drejtën, me diskrecionin e saj të vetëm, të mos zëvendësojë pajisjen e posaçme në rast keqpërdorimi ose të mos riaktivizojë një llogari të përdoruesit të pajisjes së posaçme.



[Bashkëlidhja 4]

Pasqyra e shpenzimeve (SOE)

Pagesat e kryera gjatë periudhës nga _____ deri _____. Data: _____

Aplikimi nr.: _____

TF nr.: _____

SOE nr.: _____

1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11
Zëri nr.	Emri dhe adresa e kontraktuesit, furnizuesit ose ofruesit të shërbimit	Numri dhe data e kontratës, faturës ose porosisë së blerjes (ose referencë tjetër)	Përshkrimi i shkurtër i mallrave, punimeve, shërbimeve ose shpenzime të tjera	Monedha dhe shuma totale e kontratës ose faturës	Shuma totale e shpenzimeve të mbuluara nga aplikimi (pa shumë të mbajtur)	Të pranueshme %	Shuma e shpenzimeve e pranueshme për financim	Shuma e paguar nga llogaria e caktuar (nëse ka)	Data e pagesës	Vërejtje
				TOTALI						

Dokumentet mbështetëse për këtë SOE ruhen në (vendosni vendndodhjen).



[Bashkëlidhja 5]

PAGESAT E KRYERA GJATË PERIUDHËS SË RAPORTIMIT
KUNDREJT KONTRATAVE QË I NËNSHTROHEN RISHIKIMIT PARAPRAK TË BANKËS BOTËRORE

Numri i kontratës	Furnizuesi	Data e kontratës	Shuma e kontratës	Data e moskundërshtimit të kontratës nga Banka Botërore	Shuma e paguar për furnizuesin gjatë periudhës	Pjesa e shumës së Bankës Botërore e paguar për furnizuesin gjatë periudhës

**VENDIM****Nr. 398, datë 1.6.2016****PËR KRITERET DHE MASËN E
PËRFITIMIT TË PAGESËS SË QIRASË
PËR STREHIM PËR PUNONJËSIN E
POLICISË SË SHTETIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 70, të ligjit nr. 108/2014, “Për Policinë e Shtetit”, me propozimin e ministrit të Punëve të Brendshme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kur punonjësi i policisë emërohet/transferohet jashtë vendbanimit të tij të përhershëm, brenda dhe jashtë vendit, i paguhet qiraja e banesës, kur nuk i sigurohet ajo.

2. Punonjësi i policisë që emërohet/transferohet jashtë vendbanimit të tij të përhershëm, brenda vendit, përfiton kompensim për qira banese, nëse emërohet/transferohet për shkak të detyrës dhe/ose për nevoja pune, në largësi mbi 36 km.

3. Masa e kompensimit për qira banese, për punonjësin e policisë të përcaktuar në pikën 2, të këtij vendimi, është si më poshtë vijon:

a) Kur punonjësi i policisë nuk merr me vete në vendëmërimin e ri të punës pjesëtarët e familjes, i paguhet qiraja e banesës për sipërfaqe banimi deri në 43.93 m²;

b) Kur punonjësi i policisë ka në ngarkim dhe një person dhe e merr në vendëmërimin e ri të punës, i paguhet qiraja e banesës për sipërfaqe banimi deri në 56.47 m²;

c) Kur punonjësi i policisë ka në ngarkim dhe dy persona dhe i merr në vendëmërimin e ri të punës, i paguhet qiraja e banesës për sipërfaqe banimi deri në 79.74 m²;

ç) Kur punonjësi i policisë, ka në ngarkim dhe tre persona a më shumë dhe i merr në vendëmërimin e ri të punës, i paguhet qiraja e banesës për sipërfaqe banimi deri në 80.50 m².

4. Numri i personave, pjesëtarë të familjes, në ngarkim të punonjësit të policisë vërtetohet me certifikatën e gjendjes familjare.

5. Njësia shpenzuese në Policinë e Shtetit bën kompensimin e qirasë së banesës të punonjësit të policisë, përkundrejt paraqitjes së kontratës së qirasë, në vlerë jo më të madhe se vlera minimale

e qirasë, e përcaktuar në vendimin nr. 469, datë 3.6.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e vlerës minimale të çmimit të referencave të qirave të ndërtesave për qëllime tatimore”. Vlera minimale mujore e çmimit të shitjes për metër katror sipërfaqe ndërtese të dhënë me qira do të përllogaritet në bazë të vlerës mesatare të shitblerjeve të banesave në tregun e lirë, sipas njësive administrative, të përcaktuara në udhëzimin e Këshillit të Ministrave “Për miratimin e kostos mesatare të ndërtimit të banesave nga Enti Kombëtar i Banesave”, që miratohet çdo vit.

6. Për përfitimin e pagesës, sipas pikës 2, të këtij vendimi, punonjësi i policisë paraqet në organin ku është transferuar dokumentacionin e mëposhtëm:

a) Kërkesë me shkrim, pranë njësies buxhetore ku është i punësuar;

b) Fotokopje të kartës së identitetit, certifikatën e gjendjes familjare;

c) Kontratën e noterizuar të qirasë së banesës ku është i transferuar;

ç) Vërtetim nga zyra vendore e regjistrimit të pasurive të paluajtshme se ai nuk ka banesë në juridiksionin ku është transferuar;

d) Vërtetim nga ALUIZNI se punonjësi i policisë nuk ka aplikuar për legalizim banese në juridiksionin ku është transferuar.

7. Titullari i njësies shpenzuese verifikon, nëpërmjet strukturave të varësisë, vërtetësinë e dokumentacionit të paraqitur nga punonjësi i policisë dhe të zbatimit të kontratës së qirasë.

8. Punonjësi i policisë që përfiton trajtim me qira banese nuk do të trajtohet me pagesë për kompensim udhëtimi, sipas pikës 1, të vendimit nr. 256, datë 25.3.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për kompensimin për privacionet dhe humbjet që i shkaktohen punonjësit të Policisë së Shtetit për shkak të nevojave të punës dhe të shërbimit”.

9. Përfitimi i kësaj pagese vazhdon deri në ndryshimin e vendbanimit të punonjësit të policisë, që nënkupton sistemimin me banesë në juridiksionin territorial të drejtorisë vendore të policisë apo komisariatit të policisë ku ai bën pjesë.

10. Punonjësit të policisë, i cili për shkak të detyrës dhe/ose për nevoja pune emërohet /transferohet jashtë vendbanimit të tij të përhershëm, jashtë vendit, i paguhet qiraja e banesës, kur nuk i sigurohet ajo.



11. Përcaktimi i apartamentit të banimit, që punonjësi i policisë do të marrë me qira, dhe i masës së pagesës së qirasë, sipas pikës 10, bëhet nga një komision vlerësimi në Drejtorinë e Policisë së Shtetit, i cili përzgjedh ofertën më të leverdishme, mbi bazën e shqyrtimit të tre ofertave të marra nga ky punonjës, nga 3 shoqëri imobiliare.

12. Punonjësi i policisë, sipas përcaktimit në pikën 10, pasi merr miratimin për ofertën e përzgjedhur, nënshkruan kontratën e qirasë së apartamentit të banimit për një periudhë 1-vjeçare, me të drejtë ripërtëritjeje me të njëjtat kushte. Kontrata e qirasë, detyrimsht, duhet të bëhet në një zyrë noteriale në shtetin respektiv.

13. Procedurat standarde të punës për verifikimin e vërtetësisë së dokumentacionit të paraqitur nga punonjësi i policisë, të lidhjes dhe zbatimit të kontratës së qirasë dhe pagesës së qirasë së banesës, sipas përcaktimeve të pikave 10, 11 e 12, të këtij vendimi, miratohen me urdhër të drejtorit të Policisë së Shtetit.

14. Fondi i përcaktuar për pagesat e qirave për strehim planifikohet çdo vit në programin buxhetor të Policisë së Shtetit.

15. Ngarkohet Ministria e Punëve të Brendshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI

Niko Peleshi

VENDIM

Nr. 399, datë 1.6.2016

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 55, DATË 27.1.2016, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR MIRATIMIN E PARAQITJES, FORMËS DHE SPECIFIKIMEVE TEKNIKE TË GRADAVE, SIMBOLEVE, UNIFORMAVE DHE SHENJAVE TË POLICISË SË SHTETIT”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 62, 97 e 98, pika 1, të ligjit nr. 108/2014, “Për Policinë e Shtetit”, me propozimin e ministrit të Punëve të Brendshme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. Në vendimin nr. 55, datë 27.1.2016, të Këshillit të Ministrave, bëhen shtesat dhe ndryshimet, si më poshtë vijon:

1. Në pikën 4 bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

a) Pas nënndarjes 4.5 shtohet nëndarja 4.6, me këtë përmbajtje:

“i. 4.6. Uniformë civile për zyrtarë e pritjes së qytetarëve në Drejtorinë e Policisë së Shtetit, sipas modelit në lidhjen nr. 3/a, që i bashkëlidhet këtij vendimi;”.

b) Në paragrafin e fundit, pas referencës “...4.4...” shtohet “... 4.6...;”.

2. Në pikën 6, pas nënndarjes 6.9 shtohet nëndarja 6.10, me këtë përmbajtje:

“6.10 periudhën tranzitore të përdorimit të uniformës që është në përdorim dhe të uniformës së re, që do të miratohet.”.

3. Në albumin bashkëlidhur vendimit bëhen ndryshimet dhe shtesat, si më poshtë vijon:

a) Në lidhjen nr. 1, në faqet 5 e 6, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

i) Përmasat “...60 mm x 58 mm...” zëvendësohen me “...60 mm x 52 mm...”;

ii) Fjalët “...përzierja; 67% pambuk – 33% fibër poliestër +/- 3%...” zëvendësohen me “...përzierja; 50% pambuk – 50% fibër poliestër +/- 3%...”;

iii) Fjalët “Pesha e tekstilit 125 g/m² +/- 5 g...” zëvendësohen me “Pesha e tekstilit 220 g/m² +/- 5 g...”;

iv) Pas fjalëve “...material plastik...” shtohen “...përveç gradave të mëdha të spaletit ceremonial, të cilat i kanë elementet brenda gradës metalike ngjyrë ari, dhe...”;

b) Në lidhjen nr. 3, në faqet 27, 31 dhe 32, shtohet pjesa e uniformës së veçantë, si më poshtë vijon:

i) “Bluzë pambuku me 3 kopsa, me mëngë të gjata, ngjyrë blu”, sipas modelit në lidhjen nr. 3/b, që i bashkëlidhet këtij vendimi;

ii) “Këpuçë vere”, sipas modelit në lidhjen nr. 3/c, që i bashkëlidhet këtij vendimi;

c) Në lidhjen nr. 3, në faqen 42, shtohet si pjesë e uniformës ceremoniale:

“Kostumi ceremonial”, për trupën ceremoniale, sipas modelit në lidhjen nr. 3/d, që i bashkëlidhet këtij vendimi;



ç) Në lidhjen nr. 4, në faqen 47, fjalët “Në pjesën e poshtme...”, zëvendësohen me “Në pjesën e sipërme...”.

II. Efektet financiare që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi të përballohen nga buxheti i shtetit për vitin 2016, për programin buxhetor “Policia e Shtetit”.

III. Ngarkohet Ministria e Punëve të Brendshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Niko Peleshi

Lidhja nr.3/a

UNIFORMA PËR ZYRAT E PRITJES SË QYTETARËVE



Lidhja nr.3/b

BLUZË PAMBUKU ME 3 KOPSA ME MËNGË TË GJATA, NGJYRË BLU



Lidhja nr.3/c

KËPUCË VERE PËR SHËRBIMET E VEÇANTA



KOSTUMI CEREMONIAL PER TRUPEN CEREMONIALE

**VENDIM****Nr. 400, datë 1.6.2016****PËR PJESËMARRJEN E FORCAVE TË
ARMATOSURA TË REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË NË OPERACIONIN
USHTARAK TË BASHKIMIT EVROPIAN,
ME MISION TRAJNUES, NË
REPUBLIKËN E MALIT, NË AFRIKË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr. 103/2012, “Për ratifikimin e marrëveshjes, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bashkimit Evropian, për krijimin e kuadrit për pjesëmarrjen e Republikës së Shqipërisë në

operacionet e menaxhimit të krizave të Bashkimit Evropian”, të neneve 3, pika 3, 6, pika 5, e 7, të ligjit nr. 9363, datë 24.3.2005, “Për mënyrën dhe procedurat e vendosjes dhe kalimit të forcave ushtarake të huaja në territorin e Republikës së Shqipërisë, si dhe për dërgimin e forcave ushtarake shqiptare jashtë vendit”, të ndryshuar, dhe të shkronjës “ç”, të nenit 11, të ligjit nr. 64/2014, “Për pushtetet dhe autoritetet e drejtimit e të komandimit të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:



1. Dërgimin e personelit të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë në operacionin ushtarak të Bashkimit Evropian, me mision trajnues (EUTM Mali), si pjesë e Grupit EOD, në mbështetje të Kompanisë së Ruajtjes së Bazës dhe në ekipin e “Task-Forcës së Stërvitjes”, në Koulikoro, në Republikën e Malit, në Afrikë, me përbërjen, si më poshtë vijon:

a) 3 ushtarakë për periudhën 8 qershor - 17 nëntor 2016;

b) 4 ushtarakë për periudhën 17 nëntor 2016–1 qershor 2017.

2. Misioni i ushtarakëve që do të marrin pjesë në operacionin ushtarak të Bashkimit Evropian është mbështetja dhe dhënia e kontributit në funksione të ndryshme EOD në Kompaninë e Ruajtjes së Bazës dhe në ekipin e “Task-Forcës së Stërvitjes”.

3. Kohëzgjatja e këtij misioni është deri në datën 1 qershor 2017. Kohëzgjatja për çdo rotacion është 6 muaj, periudhë së cilës i shtohen edhe ditët e qëndrimit për ndërrimin me përfaqësuesin e radhës.

4. Venddislokimi i personelit të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë është në bazën e operacionit ushtarak të Bashkimit Evropian, në Koulikoro, në Republikën e Malit, në Afrikë.

5. Ministria e Mbrojtjes, për ushtarakët pjesëmarrës në këtë operacion, përballon shpenzimet, për:

a) dieta për ditët e qëndrimit, në masën 12 000 (dymbëdhjetë mijë) lekë në ditë, përveç pagës mujore;

b) sigurimin e jetës;

c) siguracionin shëndetësor jashtë zonës së operacionit;

ç) mbështetje shëndetësore;

d) shpenzime për telefon, internet dhe shërbime postare;

dh) transport;

e) transportimin e individëve të shkëputur nga misioni për në atdhe, në rast vdekjeje, sëmundjeje ose thyerje disipline;

ë) aktivitete social-kulturore, në rastet e festave kombëtare, gjatë kohës së kryerjes së misionit;

f) çdo shpenzim tjetër për mbarëvajtjen e kryerjes së operacionit.

6. Transporti i personelit që do të shërbejë në Republikën e Malit ndërsa nis, ndryshon dhe përfundon detyrën për t’u kthyer në Shqipëri, mbështetja shëndetësore, akomodimi, ushqimi, lavanteria, transporti i individëve të shkëputur nga misioni për në atdhe, në rast vdekjeje, sëmundjeje apo thyerjeje disipline do të përballohet nga pala shqiptare, përveç rasteve kur do të arrihet nënshkrimi i marrëveshjeve dypalëshe, ku pala tjetër të marrë përsipër këto shpenzime.

7. Ministria e Mbrojtjes të bëjë sigurimin e jetës nga aksidentet për ushtarakët e Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, të cilët do të marrin pjesë në këtë mision.

8. Efektet financiare që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi të përballohen nga fondet e miratuara në buxhetin e Ministrisë së Mbrojtjes.

9. Ngarkohet ministri i Mbrojtjes për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI

Niko Peleshi

VENDIM

Nr. 401, datë 1.6.2016

PËR MIRATIMIN E STRATEGJISË AFATMESME TË MENAXHIMIT TË BORXHIT 2016–2018

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 6, të ligjit nr. 9665, datë 18.12.2006, “Për huamarrjen shtetërore, borxhin shtetëror dhe garancitë shtetërore të huas në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e Strategjisë Afatmesme të Menaxhimit të Borxhit 2016–2018, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Ngarkohet Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI

Niko Peleshi



STRATEGJIA AFATMESME E MENAXHIMIT TË BORXHIT 2016–2018

Akronime

AMF	Autoriteti i Mbikqyrjes Financiare
BB	Banka Botërore
BE	Bashkimi Evropian
BKT	Banka Kombëtare Tregtare
BQE	Banka Qendrore Evropiane
BSH	Banka e Shqipërisë
EUR	Monedha e Bashkimit Evropian
FMN	Fondi Monetar Ndërkombëtar
KMM	Koha Mesatare në Maturim
KMR	Koha Mesatare në Rivlerësim
LEK	Monedha Vendase
NPL	Non Performing Loans (Kredi me performancë jo të mirë)
PBB	Prodhimi i Brendshëm Bruto
PBG	Policy Based Guarantee (Garanci Pjesore)
PB	Pikë bazë
PP	Pikë përqindje
SAMB	Strategjia Afatmesme e Menaxhimit të Borxhit
USD	Monedha kombëtare e Shteteve të Bashkuara të Amerikës
YEN	Monedha kombëtare e Japonisë
YMP	Yieldi Mesatar i Ponderuar



Hyrje

Objektivat¹ e përgjithshme të menaxhimit të borxhit janë:

- i. Sigurimi i realizimit të nevojave të Qeverisë për financim, si edhe nevojave për të shërbyer borxhin aktual me kosto sa më të ulët dhe duke mbajtur nivele të pranueshme të ekspozimit ndaj rrezikut.
- ii. Zhvillimi i tregut primar dhe sekondar të titujve shtetërorë.

Në funksion të realizimit të objektivave të sipërpërmendura përgatitet edhe Strategjia Afatmesme e Menaxhimit të Borxhit (SAMB) e cila përditësohet dhe publikohet nga Ministria e Financave në bazë vjetore. SAMB është në linjë me kuadrin Makro-fiskal dhe me politikat monetare që implementohen nga Banka e Shqipërisë gjatë periudhës afatmesme 2016-2018. SAMB është vazhdimësi e strategjisë paraardhëse dhe karakterizohet nga të njëjtat objektiva.

SAMB mbulon menaxhimin e Borxhit të Qeverisjes Qendore, në të cilin përfshihet Borxhi Shtetëror dhe Borxhi Shtetëror i Garantuar. Qëllimi i SAMB është të orientojë huamarrjen drejt instrumenteve me kosto të favorshme dhe me nivele të pranueshme të ekspozimit ndaj rrezikut për nivele të caktuara të financimit. Nivelet e financimit përcaktohen në kuadrin Makro-fiskal dhe Planin Afatmesëm Buxhetor të ndarë në Plane Vjetore të Huamarrjes.

Menaxhimi i borxhit të brendshëm do të vazhdojë të fokusohet në uljen e rrezikut të refinancimit dhe atij të normave të interesit, për të ulur më tej nivelin ende të lartë të titujve me afat të shkurtër maturimi. Në këtë kuadër, SAMB në periudhën afatmesme 2016-2018 do të synojë financimin e brendshëm kryesisht nëpërmjet titujve afatgjatë me norma interesi fikse. Normat e interesit në nivelet minimale historike, e bëjnë zbatimin e kësaj strategjie më pak të kushtueshme duke garantuar një raport optimal ndërmjet koston dhe rrezikut.

Financimi i huaj do të mbështetet në financimin me terma të butë nga institucionet ndërkombëtare të zhvillimit të projekteve ekzistuese, projekteve të reja të konsideruara si prioritare nga Qeveria për zhvillimin e vendit, si edhe në mbështetjen buxhetore të akorduar nga BB dhe FMN. Nuk përjashtohet mundësia që gjatë periudhës afatmesme 2016-2018 të ketë edhe një dalje me Eurobond në tregjet ndërkombëtare të kapitalit, me qëllim rritjen e mëtejshme të jetgjatësisë së borxhit, duke synuar zgjatjen e *benchmark-ut*² për titujt afatgjatë dhe uljen e presionit të huamarrjes në tregun e brendshëm.

Zhvillimi i mëtejshëm i tregut primar të titujve shtetërorë është një tjetër objektiv i strategjisë së borxhit. Në këtë kuadër gjatë periudhës afatmesme do të synohet ndërmarrja e aktiviteteve specifike të mëposhtme:

- i. Shmangia e segmentimit të kërkesës për titujt shtetërorë nëpërmjet tërheqjes nga tregu të një ose disa titujve që konkurojnë njëri tjetrin;
- ii. Krijimi i madhësive benchmark për titujt shtetërorë afatgjatë duke përdorur rihapjen më të shpeshtë të ankandëve ekzistuese;
- iii. Konsultimi i vazhdueshëm dhe i rregullt me aktorët kryesorë të tregut;
- iv. Diversifikimi dhe zgjerimi i bazës së investitorëve.

¹ Referuar ligjit Nr. 9665, datë 18.12.2006, i ndryshuar, për “Huamarrjen Shtetërore, Borxhin Shtetëror dhe Garantitë Shtetërore të Huasë në Republikën e Shqipërisë”

² Shpjegimi i termave teknikë gjendet në fund të dokumentit, në aneksin “Fjalor Teknik”

I. ZHVILLIMET E BORXHIT TË QEVERISJES QENDRORE

1. Menaxhimi i Borxhit dhe Realizimi i Objektivave

Menaxhimi i borxhit gjatë vitit 2015 ka pasur si objektiv kryesor sigurimin e financimit të nevojave të Qeverisë për të shërbyer detyrimet që lindin nga borxhi ekzistues, si edhe detyrimet e krijuara nga diferenca ndërmjet të ardhurave dhe shpenzimeve. Në të njëjtën kohë, shumë e rëndësishme për menaxhimin e borxhit ka qenë realizimi i objektivit të sipërpërmendur në përputhje me objektivat strategjike për uljen e ekspozimit ndaj rreziqeve dhe mbajtjen nën kontroll të kostove të asociuara me borxhin.

Viti 2015 ka qenë një vit intensiv për menaxhimin e borxhit të Republikës së Shqipërisë për shkak të nivelit të lartë të financimit të borxhit ekzistues, ku vlen të përmendet kryesisht rifinancimi i rreth 60.3% e borxhit të brendshëm dhe rifinancimi i Eurobondit të emetuar në vitin 2010 në vlerën e 41.6 miliardë lekë.

Gjatë vitit 2015 nëpërmjet instrumenteve të borxhit të brendshëm dhe të jashtëm gjithsej u financuan 544.2 miliardë lekë ose 37.7% e PBB. *(nënkapitulli 3.)*

Pavarësisht nivelit të lartë për t'u financuar, menaxhimi i borxhit në bashkëpunim me strukturat e tjera përgjegjëse për menaxhimin e likuiditetit në Ministrinë e Financave, financoi me sukses të gjitha nevojat e Qeverisë Qendrore duke realizuar në të njëjtën kohë objektivat strategjike për:

- (i) Uljen e ekspozimit ndaj rreziqeve *(rrezikut të rifinancimit, rrezikut të normave të interesit dhe rrezikut të likuiditetit)*;
- (ii) Uljen e kostove të borxhit;
- (iii) Uljen e presionit të huamarrjes në tregun e brendshëm;
- (iv) Ri-afirmimin e Shqipërisë në tregjet ndërkombëtare të kapitalit.

Instrumentet që mundësuan realizimin e objektivave strategjike janë obligacionet afatgjata (7 vjeçare dhe 10 vjeçare) në tregun e brendshëm, si edhe PBG dhe Eurobond-i në tregun e jashtëm.

Në kuadër të uljes së ekspozimit ndaj rreziqeve menaxhimi i borxhit u fokusua në dy drejtime kryesore: (i) në drejtim të rritjes së peshës së instrumenteve afatgjata nëpërmjet emetimit të obligacioneve 7 dhe 10 vjeçare me norma interesi fikse, dhe (ii) në drejtim të uljes së peshës së instrumenteve me afat maturimi relativisht të ulët nëpërmjet procedurës së maturimit dhe buyback, që u mundësua nga shtesa (400 milion EUR) e financimit nga instrumenti i PBG dhe Eurobond. *(nënkapitulli 2.2.)*

Ulja e ekspozimit ndaj rreziqeve zakonisht shoqërohet me rritje të kostos, por gjatë vitit 2015 menaxhimi i borxhit e ka realizuar këtë objektiv me një kosto relativisht të ulët, duke shfrytëzuar rënien e normave të interesit për titujt afatgjatë në tregun e brendshëm, si edhe

duke financuar 700 milion EUR (*PBG+Eurobond*) në tregun e jashtëm me një kosto mesatare prej 3.5%³ dhe jetgjatësi mesatare prej 7.25 vite. (*nënkapitulli 3.1*)

Nga ana tjetër, vetë shtesa e financimit nga PBG dhe Eurobond ka bërë të mundur uljen e ofertës për hua në tregun e brendshëm, duke ulur presionin mbi normat e interesit dhe duke stimuluar rritjen e kreditimit të sektorit privat.


Emetimi i Eurobond-it në muajin nëntor, përveç se mundësoi rifinancimin e Eurobondit ekzistues, mundësoi përmirësimin e strukturës së borxhit të brendshëm, shërbeu edhe si instrument për përmirësimin e imazhit dhe riafirmimin e vendit në tregjet ndërkombëtare të kapitalit.

2. Ecuria e Borxhit të Qeverisjes Qendore

Në fund të vitit 2015 niveli i borxhit të Qeverisë Qendrore vlerësohet në nivelin e 72.1% në raport me PBB.

Deri në fund të vitit 2012 rritja e borxhit i atribuohet kryesisht zgjerimit të defiçitit buxhetor dhe rritjes së ngadalësuar ekonomike. Ndërkohë, duke filluar nga viti 2013, njohja e detyrimeve dhe faturave të papaguara të akumuluarra (*rreth 5 për qind të PBB-së*), çoi në rritje të raportit të borxhit ndaj PBB-së. Duke filluar nga viti 2014, hartimi i një programi ekonomik fiskal dhe reformat e ndërmarra veçanërisht në fushën e energjisë, kanë ulur ritmin e akumulimit të borxhit dhe kanë përshpejtuar ritmet e rritjes ekonomike. Si rrjedhojë, niveli i borxhit pritet të ulet deri në 60% të PBB në fund të vitit 2019.

Gjatë vitit 2015 borxhi i Qeverisjes Qendore në raport me PBB është rritur me 2.3 pp dhe të gjithë peshën e rritjes e ka mbajtur borxhi i jashtëm, ndërkohë që borxhi i brendshëm ka pësuar rënie. Rritja e borxhit të jashtëm ka ardhur si rezultat i kushteve të favorshme në tregun e jashtëm dhe si rezultat i përpjekjes së Qeverisë për të ulur presionin e huamarrjes së brendshme dhe për t'i dhënë frymëmarrje kreditimit të sektorit privat. (*Paraqitje grafike1*)



Burimi: Ministria e Financave

³ Një borxh me karakteristika të ngjashme rreziku në tregun e brendshëm do të financohej me rreth dyfishin e koston.


2.1. Portofoli i Borxhit Shtetëror

Në dhjetor 2015 portofoli i borxhit shtetëror vlerësohet në 986.1 miliardë lekë ose 94.6 % e portofolit të borxhit të Qeverisjes Qendrore. Raporti ndërmjet borxhit të brendshëm dhe të jashtëm shtetëror është 52.8% me 47.2%.

2.1.1. Përbërja sipas instrumenteve

Borxhi i brendshëm shtetëror përbëhet 100% nga instrumente të tregtueshme, të tipit bono thesari dhe obligacione. Ndërkohë, borxhi i jashtëm shtetëror përbëhet në masën 86.6% nga instrumente të patregtueshme, si kreditë e projekteve për zhvillim, mbështetja buxhetore dhe kredia pjesërisht e garantuar nga Banka Botërore (PBG). Pjesa e mbetur prej 13.4% përbëhet nga instrumente të tregtueshme në tregjet ndërkombëtare, të tipit Eurobond. (Paraqitje grafike 2)

Paraqitje Grafike 2: Kompozimi i stokut të borxhit shtetëror sipas instrumenteve



Burimi: Ministria e Financave

Gjatë viteve të fundit borxhi i brendshëm është karakterizuar nga rritja e vazhdueshme e peshës së obligacioneve, si pjesë e politikave menaxhuese për uljen e ekspozimit ndaj rreziqeve.


Ndërkohë, borxhi i jashtëm karakterizohet nga rritja e peshës së mbështetjes buxhetore. Rritja e këtij komponenti është e lidhur me politikat e Qeverisë për të likujduar detyrimet e prapambetura, me qëllim uljen e nivelit të NPL-ve në ekonomi dhe për të stimuluar rritjen e kreditimit ndaj sektorit privat.

⁴ Të dhënat janë paraprake për shkak të rivlerësimit që i bëhet borxhit të jashtëm. Ndryshimet që mund të pasohen nga rivlerësimi i borxhit të jashtëm në të ardhmen janë minimale dhe nuk kanë ndikim domethënës mbi analizat që pasojnë në këtë dokument.

2.1.2. Përbërja sipas monedhave

Në fund të vitit 2015 rreth 51.4% e borxhit shtetëror është e denominuar në monedhë vendase, ndërkohë pjesa tjetër është në monedhë të huaj dhe mbizotëron në rreth 70% monedha Euro. (Paraqitje grafike 3) Rreth 97.2% e borxhit të brendshëm është e denominuar në monedhë vendase, ndërkohë që borxhi i jashtëm është tërësisht i denominuar në monedhë të huaj.

Paraqitje Grafike 3: Kompozimi i stokut të borxhit shtetëror sipas monedhave




Burimi: Ministria e Financave

2.1.3. Përbërja sipas jetgjatësisë

Në dhjetor 2015, rreth 77.1% e borxhit shtetëror është e përbërë nga instrumente me jetgjatësi më të lartë se një vit. Borxhi jashtëm është i përbërë tërësisht nga instrumente me afat të gjatë maturimi, ndërkohë tek borxhi i brendshëm instrumentet afatgjata zënë rreth 57.0% të portofolit. Jetgjatësia mesatare e borxhit të brendshëm dhe të jashtëm, janë përkatësisht 1.96 dhe 8.1 vite. Për portofolin e borxhit të brendshëm viti 2015 ka qenë një vit mjaft pozitiv në kuadër të shtimit të peshës së instrumenteve me afat të gjatë maturimi. Në këtë aspekt, krahasuar me vitin e kaluar pesha e borxhit afatgjatë në portofol është rritur me 5.4 pp. Rritja e dukshme e peshës në kategorinë e instrumenteve afatgjata ka ardhur kryesisht si rezultat i emetimit të suksesshëm të obligacionit 10-vjeçar dhe si rezultat i nivelit të ulët të maturimeve në këtë kategori instrumentesh.

Paraqitje Grafike 4: Përbërja e borxhit të brendshëm shtetëror sipas jetgjatësisë



Burimi: Ministria e Financave

2.1.4. Përbërja sipas tipit të interesit

Në fund të vitit 2015, rreth 68.2% e portofolit të borxhit shtetëror është e përbërë nga norma interesi fikse dhe rreth 22.6% e këtij portofoli kompozohet nga norma interesi konçesionale. Borxhi i brendshëm përbëhet nga instrumente kryesisht me norma interesi fikse në masën 86.1% dhe është tërësisht me norma interesi tregtare. Ndërkohë, borxhi i jashtëm përbëhet në masën 48.1% nga norma interesi fikse dhe 47.9% nga norma interesi konçesionale. (Tabela 1)

Tabela 1: Përbërja e borxhit shtetëror sipas tipit të interesit (2014-2015)

Tipi Interesit	2014			2015		
	Borxh i Brendshëm	Borxh i Jashtëm	Total	Borxh i Brendshëm	Borxh i Jashtëm	Total
Interes Fiks	85.4%	50.2%	70.8%	86.1%	48.1%	68.2%
Interes Variabël	14.6%	49.8%	29.2%	13.9%	52.0%	31.8%
Interes Konçesional	0.0%	51.8%	21.6%	0.0%	47.9%	22.6%
Interes Tregtar	100.0%	48.2%	78.4%	100.0%	52.1%	77.4%

Burimi: Ministria e Financave

2.2. Portofoli i Borxhit të Garantuar


Në dhjetor 2015 portofoli i borxhit të garantuar vlerësohet në 56.0 miliardë lekë, 3.9% e PBB ose 5.4% e portofolit të borxhit të Qeverisjes Qendore. Rreth 54.3% e portofolit të borxhit të garantuar janë emetuar në tregun e brendshëm dhe 45.7% në tregun e jashtëm. Krahasuar me vitin e kaluar borxhi i garantuar është rritur me 1.5 miliardë lekë, për shkak të emetimit të tre garancive të reja në vlerën e përgjithshme 12.9 miliardë lekë. (Tabela 2)

Tabela 2: Garancitë shtetërore të emetuara gjatë vitit 2015

Subjekti Garantuar	Objekti i Garancisë	Vlera (në mld lekë)	Investitori
KESH Sha.	Garantimi i linjave ekzistuese të overdrafteve	4.5	Sistemi Bankar Vendas
OST	Efienca energjitike	5.6	KfW
RTSH	Ndërtimi i rrjeteve numerike	2.8	Deutsche Bank

Burimi: Ministria e Financave

Rreth 95% e garancive të Shtetit Shqiptar janë emetuar në favor të sektorit të Energjisë, sektorit të Ujësjetës Kanalizimeve dhe sektorit të Transportit. (Paraqitje grafike 5)

Paraqitje Grafike 5: Garancitë shtetërore sipas sektorëve ekonomik


Burimi: Ministria e Financave

3. Kostot dhe Rreziqet e Borxhit Shtetëror

Gjatë vitit 2015 portofoli i borxhit shtetëror është karakterizuar nga mbajtja e raporteve të qëndrueshme ndërmjet kostos dhe rrezikut, në përputhje me objektivat strategjike. Kostot e borxhit janë ulur kryesisht për shkak të rënies së normave të interesit në tregun vendas dhe atë të huaj. Struktura e borxhit ka pësuar ndryshime në kuadër të përmirësimit të rreziqeve, ku kryesisht janë bërë përmirësime në kuadër të uljes së ekspozimit ndaj rrezikut të rifinancimit dhe rrezikut të normave të interesit. Ndërkohë përse i përket rrezikut të kursit të këmbimit, vërehet një rritje e moderuar e ekspozimit.

3.1. Kostot

Gjatë vitit 2015 kosto e borxhit shtetëror që rrjedh nga pagesat e interesave vlerësohet në 38.6 miliardë lekë ose 2.67% e PBB ku 1.9% e PBB janë pagesa për interesat e borxhit të brendshëm dhe 0.78% e PBB interesa për borxhin e jashtëm. Gjatë viteve të fundit pagesat për interesa kanë pasur një trend rënës, i cili ka ardhur kryesisht si rezultat i rënies së normave të interesit në tregun e brendshëm dhe të jashtëm.


Paraqitje Grafike 6: Pagesat për interesa të borxhit shtetëror

Burimi: Ministria e Financave

Referuar paraqitjes grafike 7, borxhi i brendshëm paraqitet më i kushtueshëm se borxhi i jashtëm, kryesisht për faktin se është borxh i emetuar tërësisht me terma tregtare dhe për

shkak të kushteve makroekonomike që karakterizojnë vendin. Megjithatë, kosto mesatare e borxhit të brendshëm ka ardhur vazhdimisht duke u ulur edhe pse në portofol është rritur pesha e instrumenteve afatgjata. Ndërkohë, kosto mesatare e borxhit të jashtëm gjatë viteve të fundit ka qënë më e qëndrueshme duke u luhatur maksimalisht me 10 pb. Përfundimisht në vitin 2015, gjatë të cilit kosto mesatare e borxhit të jashtëm është rritur me 29 pb, kryesisht për shkak të rritjes së peshës së borxhit të kontraktuar me terma tregtare (*jo konçesionale*).

Paraqitje Grafike 7: Kosto mesatare e borxhit të brendshëm dhe të jashtëm



Burimi: Ministria e Financave

3.2. Rreziqet

Viti 2015 ka qënë një vit mjaft pozitiv në kuadër të uljes së ekspozimit ndaj rreziqeve që mbart borxhi. Rreziqet që lidhen me borxhin janë ulur ose janë mbajtur nën kontroll në përputhje me objektivat strategjike të vendosura në strategjinë paraardhëse.

Ulja e rrezikut të rifinancimit dhe atij të normave të interesit kanë ardhur kryesisht si rezultat i uljes së peshës së titujve afatshkurtër dhe uljes së peshës së titujve me norma interesi të ndryshueshme në portofolin e borxhit të brendshëm. Në këtë drejtim ka kontribuar ulja e financimit të brendshëm si rezultat i shtesës së financimit të huaj nga instrumenti i PBG (+250 milion Euro) dhe Eurobondi (+150 milion Euro), si edhe kërkesa e kënaqshme për titujt shtetërorë afatgjatë. Ulja e financimit të brendshëm përveç se ka ulur presionin e ofertës për titujt shtetërorë nga ana e Qeverisë, ka bërë të mundur edhe maturimin e titujve (*maturimi nëpërmjet procedurës Buyback*) me maturitet të mbetur relativisht të ulët, duke kontribuar në përmirësimin e strukturës së borxhit të brendshëm përtej pritshmërive.

Megjithëse rreziku i kursit të këmbimit ka devijuar nga objektivi fillestar i strategjisë, ai mbetet nën kontroll. Devijimi ka qënë i moderuar dhe përfitimet nga ky devijim në kuadër të uljes së ekspozimit ndaj rrezikut të rifinancimit dhe rrezikut të normave të interesit në tregun e brendshëm kanë qënë më të larta. Nga ana tjetër, rritja e financimit të huaj ka kontribuar edhe në uljen e presionit të normave të interesit në tregun e brendshëm duke ulur kostot e borxhit.



3.2.1. Rreziku i rifinancimit

Ulja e rrezikut të rifinancimit, veçanërisht në portofolin e borxhit të brendshëm, është një nga objektivat kryesore të menaxhimit të borxhit.

Borxhi i jashtëm paraqet më pak rrezik pasi është i përbërë nga instrumente me afat të gjatë maturimi dhe me profile amortizimi të shtrira gjatë në kohë. Ndërkohë borxhi i brendshëm është i ekspozuar në shkallë më të lartë ndaj këtij rreziku për shkak të peshës së konsiderueshme që zenë instrumentet afatshkurtra. (Paraqitje grafike 8)

Në dhjetor 2015 struktura e borxhit të brendshëm paraqitet më pak e ekspozuar kundrejt rrezikut të rifinancimit, pasi ka një përmirësim në shpërndarjen e detyrimeve që lindin nga ripagesat e borxhit ekzistues. Pesa e instrumenteve (në përqindje të totalit), që rifinancohen në harkun kohor të një viti është 55.9%, rreth 4.4 pp më e ulët se fundin e vitit të kaluar dhe 3.5 pp përtej objektivit strategjik. (Paraqitje grafike 9)

Paraqitje Grafike 8: Profilet e amortizimit të borxhit shtetëror



Burimi: Ministria e Financave



Në dhjetor 2015 koha mesatare në maturim (*KMM*) e portofolit të borxhit shtetëror rezulton në 4.9 vite, përkatësisht 2.0 vite për borxhin e brendshëm dhe 8.0 vite për borxhin e jashtëm. Krahësuar me fundin e vitit të kaluar ky tregues ka një përmirësim prej 0.7 vitesh, përkatësisht 0.2 vite për borxhin e brendshëm dhe 0.5 vite për borxhin e jashtëm. Objektivat strategjike janë realizuar duke u tejkaluar me 0.2 vite për borxhin e brendshëm dhe 0.1 vite për borxhin e jashtëm. (Tabela 3)

Jetgjatësia e borxhit të brendshëm është rritur si pasojë e maturimit të instrumenteve afatshkurtra nëpërmjet procedurave të buyback si edhe për shkak të shtimit të peshës së instrumenteve afatgjata (*kryesisht obligacioneve 7 dhe 10 vjeçare*) në portofol. Ndërkohë jetgjatësia e borxhit të jashtëm është rritur për shkak të maturimit të disa instrumenteve me jetgjatësi të mbetur relativisht të ulët (*Eurobondi 2010*) dhe zëvendësimi me instrumente të reja me jetgjatësi më të lartë (*Eurobondi 2015*). Gjithashtu edhe emetimi i PBG në vlerën e 250 milion Euro dhe me maturitet mesatar prej 8.75 vite ka luajtur një rol të rëndësishëm në rritjen e jetgjatësisë së borxhit të jashtëm.

Tabela 3: Treguesit e rrezikut të rifinancimit

Treguesi	2015			Objektivi Strategjik		
	Borxh i Brendshëm	Borxh i Jashtëm	Total	Borxh i Brendshëm	Borxh i Jashtëm	Total
Borxh që maturohet brenda një viti (Në % të totalit)	55.9	4.3	31.6	59.4	5.5	35.4
KMM (Vite)	2.0	8.0	4.9	1.8	7.9	4.5

Burimi: Ministria e Financave

Përpjekjet për uljen e rrezikut të rifinancimit do të vazhdojnë, pasi borxhi i brendshëm mbetet ende i ekspozuar ndaj rrezikut të rifinancimit dhe ka nevojë për përmirësime të mëtejshme në kuadër të rritjes së peshës së instrumenteve afatgjata dhe krijimit të një profili amortizimi me shpërndarje më të njëtrajtshme.

3.2.2. Rreziku i normave të interesit

Gjatë vitit 2015 është bërë progres i dukshëm në kuadër të uljes së ekspozimit ndaj rrezikut të normave të interesit. Në këtë aspekt rol të rëndësishëm ka luajtur mbajtja nën kontroll e instrumenteve me norma interesi të ndryshueshme si edhe ulja e peshës së instrumenteve afatshkurtra në portofol, të cilat në aspektin e rrezikut të normave konsiderohen me norma të ndryshueshme.

Borxhi me norma interesi fikse në fund të vitit 2015 vlerësohet rreth 48.6% e totalit të portofolit ose 6.1 pp më shumë se fundin e vitit të kaluar. Për borxhin e brendshëm ky tregues është rritur me 6.2 pp krahasuar me fundin e vitit të kaluar, kryesisht për shkak të uljes së peshës së instrumenteve afatshkurtra nga 48.4% në 43.0%. Gjithashtu edhe pesha e instrumenteve që rivlerësohen në harkun kohor të një viti është ulur nga 65.9% në 58.1%. Kontribut në përmirësimin e këtij treguesi ka jo vetëm borxhi i brendshëm për arsyet e sipërpërmendura por edhe borxhi i jashtëm, i cili është më i qëndrueshëm pas maturimit të disa instrumenteve me peshë relativisht të lartë dhe zëvendësimit me instrumente të reja me jetgjatësi të mbetur dhe kohë rivlerësimi relativisht të lartë.

**Tabela 4:** Treguesit e rrezikut të normave të interesit

Treguesi	2015			Objektivi Strategjik		
	Borxh i Brendshëm	Borxh i Jashtëm	Total	Borxh i Brendshëm	Borxh i Jashtëm	Total
Borxh me normë fikse/total	43.2%	54.6%	48.6%	40.9%	55.8%	48.8%
Borxhi i rivlerësuar në një vit KMR	67.7%	47.3%	58.1%	70.8%	46.7%	60.1%
	1.82	4.8	3.2	1.63	4.6	3.0

Burimi: Ministria e Financave

Referuar tabelës 4 rezulton se objektivat strategjikë për mbajtjen nën kontroll të rrezikut të normave të interesit janë realizuar me sukses.

Objektivi i uljes së mëtejshme të ekspozimit ndaj rrezikut të normave të interesit, do të vazhdojë të jetë ndër objektivat bazë të SAMB, duke qënë se më shumë se 58% e portofolit të borxhit shtetëror rivlerësohet në harkun kohor të një viti dhe borxhi publik vazhdon të ketë ekspozim relativisht të lartë ndaj lëvizjes së normave të interesit. Goditjet në normat e interesit në tregun e brendshëm dhe të jashtëm mund të shoqërohen me rritje të shpenzimeve në buxhet dhe rritje të nivelit të borxhit.

3.2.3. Rreziku i kursit të këmbimit

Stoku i borxhit shtetëror të denominuar në monedhë të huaj është rritur nga 43.1% e totalit në vitin 2014 në 48.5% në vitin 2015, duke sjellë një rritje të moderuar të ekspozimit ndaj rrezikut të kursit të këmbimit. (Tabela 5)

Tabela 5: Stoku i borxhit shtetëror në monedhë vendase dhe të huaj

Monedha	2014		2015		Objektivi Strategjik
	Në milion Lekë	Në %	Në milion Lekë	Në %	Në %
Vendase	524,995.6	56.9%	506,508.7	51.5%	Min 55%
E huaj	397,567.3	43.1%	477,927.9	48.5%	Max 45%

Burimi: Ministria e Financave

Rritja e nivelit të borxhit në monedhë të huaj ka ardhur kryesisht nga mbështetja buxhetore e akorduar në kuadër të likuidimit të detyrimeve të prapambetura, garancia pjesore e bankës botërore (PBG) dhe Eurobondi. Shtesa prej 3.5% e financimit të huaj mbi objektivin është bërë në kuadër të kostove të favorshme që kanë rezultuar në tregun e jashtëm gjatë emetimit të Eurobond-it, në kuadër të lehtësimit të mëtejshëm të presionit të huamarrjes në tregun e brendshëm dhe në kuadër të uljes së ekspozimit ndaj rrezikut të rifinancimit dhe rrezikut të normave të interesit.


Rreth 70.0% e portofolit në monedhë të huaj përbëhet nga monedha Euro, duke e bërë këtë portofol jo shumë të diversifikuar. Megjithatë, pesha e lartë e portofolit në monedhën Euro është në përputhje me objektivat strategjikë dhe me aspiratat e vendit për tu integruar në një të ardhme të afërt në Bashkimin Europian.

Nga ana tjetër, ekspozimi i lartë ndaj kësaj monedhe nuk ka përbërë shqetësim pasi gjatë viteve të fundit monedha Euro nuk ka qenë shumë volatile në raport me monedhën vendase, për shkak të marrëdhënieve ekonomike me vendet e BE.

Referuar *paraqitjes grafike 9* rezulton se gjatë katër viteve të fundit maksimumi i luhatjes së kursit të këmbimit EUR/LEK ka qenë 1.4%. Ndërkohë, monedha vendase ka pasur luhatje që arrijnë deri në 6.0% kundrejt monedhës USD, që është dhe monedha e dytë më e rëndësishme për sa i përket peshës në portofolin e borxhit.

Gjatë viteve të fundit kostot nga ndryshimet në kursin e këmbimit kanë qenë të moderuara. Kontribut në këtë aspekt ka lëvizja në kah të kundërt e monedhës EUR dhe USD, si edhe fakti që shumica e ripagesave të instrumenteve të borxhit të huaj janë të shpërndara gjatë në kohë dhe ripaguhet në disa këste.

Paraqitje Grafike 9: *Nryshimi në kursin e këmbimit EUR/LEK dhe USD/LEK (2012-2015)*




Burimi: Ministria e Financave

Pavarësisht ekspozimit jo të lartë të portofolit në monedhë të huaj, në të ardhmen është shumë e rëndësishme që të bëhet kujdes me rritjen e mëtejshme të ekspozimit, pasi mund të ketë ndikim në uljen qëndrueshmërisë së borxhit dhe në aftësinë ripaguese të Shtetit për detyrimet në valutë.

Raporti i borxhit në monedhë të huaj kundrejt eksporteve dhe rezervës valutore janë indikatorë shumë të rëndësishëm, të cilët vlerësojnë aspektin e mësipërm.

Gjatë viteve të fundit këto dy raporte janë rritur duke treguar një rënie në aftësinë ripaguese në valutë. Duke filluar prej vitit 2013 ritmet e rritjes së borxhit në monedhë të huaj kanë qenë më të larta se ritmet e rritjes së eksporteve dhe rezervës valutore. (*Paraqitje grafike 10*)

Paraqitje Grafike 10: *Raporti i borxhit të jashtëm ndaj eksporteve dhe rezervës valutore*



Burimi: Ministria e Financave


Megjithëse efektet e kursit të këmbimit kanë qenë të moderuara, në të ardhmen është e rëndësishme që borxhi i jashtëm të rritet me ritme proporcionale me eksportet dhe rezervën valutore.

3.2.4. Rreziku i likuiditetit

Viti 2015 ka qenë një vit me nevoja të larta likuiditeti kryesisht për shkak të nivelit të lartë të maturimeve të borxhit në vlerën e 489.4 miliardë lekë, ose 79.9 miliardë lekë më shumë se në vitin 2014. Kjo është e lidhur kryesisht me maturimin e Eurobondit në vlerën e 300 milion Euro (rreth 41.6 miliardë lekë). Pavarësisht nevojave të larta të rifinancimit, ky vit u arrit të menaxhohej me sukses duke mos krijuar vonesa në pagesat e detyrimeve që lindin prej borxhit si edhe duke mos krijuar ankande të jashtzakonshme, të cilat mund të krijojnë konfuzion tek investitorët dhe presion rritës mbi normat e interesit. Faktorë kyç në menaxhimin e suksesshëm ka qenë mirëplanifikimi i financimit, koordinimi i mirë me njësinë (*Drejtorinë e Thesarit*) përgjegjëse për parashikimin e flukseve të të ardhurave, si edhe shfrytëzimi i burimeve të reja të financimit në tregun e jashtëm (*PBG*) për ti dhënë frymëmarje tregut të brendshëm.

Pavarësisht uljes së kostos së borxhit për njësi, treguesi i raportit të shërbimit të borxhit me të ardhurat sinjalizon rritje të rrezikut të likuiditetit, kryesisht për shkak të rritjes së ripagesave të borxhit jashtëm.

Paraqitje Grafike 11: Shërbimi i borxhit në raport me të ardhurat



Burimi: Ministria e Financave

Përmirësimi i këtij treguesi është i lidhur ngushtë me uljen e borxhit, me konsolidimin e të ardhurave në buxhet dhe me uljen e mëtejshme të kostos së borxhit.

Përsa i përket objektivave strategjike për mbajtjen nën kontroll të rrezikut të likuiditetit rezultojnë se disa prej objektivave janë realizuar me sukses, ku këtu vlen të përmendet realizimi për herë të parë i transaksioneve buyback duke maturuar instrumente me jetëgjatësi të mbetur relativisht të ulët. Përsa i përket shpërndarjes së peshës së disa ankandëve me vlera të larta, ky objektivi nuk është realizuar për shkak të emetimit të Eurobondit në gjysmën e dytë të vitit dhe mbajtjes së financimit të PBG në formën e garancisë duke konsideruar edhe skenarin më të keq për mosrealizimin e emetimit të Eurobondit gjatë vitit 2015.



3.2.5. Rreziku operacional

Rreziku operacional gjatë viteve të fundit ka pasur një përmirësim në kuadër të shtimit të kapaciteteve dhe përmirësimit të mjeteve analitike të përdorura në menaxhimin e borxhit. Këtu mund të përmendet trajnimi i stafit dhe bashkëpunimi i vazhdueshëm me institucionet ndërkombëtare si BB dhe FMN në kuadër të adaptimit të praktikave më të mira ndërkombëtare për menaxhimin e borxhit dhe zhvillimin e tregut të titujve shtetërorë. Gjithashtu është hartuar një draft manual për veprimtaritë e brendshme të njësisë menaxhuese të borxhit publik.

Stafi ekzistues zotëron aftësi të mira teknike, por është nën numrin optimal që kërkohet nga struktura, duke e rritur rrezikun e individëve kyç (*key person risk*). Borxhi i brendshëm dhe i jashtëm vazhdojnë të ruhen në databaza të veçanta, duke e bërë të vështirë dhe me rrezik të lartë raportimin dhe përpunimin e të dhënave. Sistemi i regjistrimit të të dhënave të borxhit të jashtëm (*DMFAS*) nuk është përditësuar ende në versionin e ri.

4. Burimet e Financimit

Gjatë vitit 2015 financimi me borxh ka shërbyer për të realizuar rifinancimin e instrumenteve të borxhit që u maturuan si edhe për të mbuluar defiçitin buxhetor.

Në dallim nga vitet e mëparshme, në vitin 2015 risi ka qenë përdorimi i instrumentit të garancisë pjesore të Bankës Botërore (*PBG*) si edhe emetimi i Eurobondit në tregjet ndërkombëtare të kapitalit.

Këto instrumente u emetuan me norma interesi të favorshme dhe mundësuan uljen e presionit të huamarrjes në tregun e brendshëm, me qëllim përmirësimin e strukturës së borxhit të brendshëm. Gjithashtu, emetimi i këtyre instrumenteve synoi zëvendësimin e një pjese të borxhit të brendshëm me borxh më të favorshëm për sa i përket rrezikut dhe kostos.

Për vitin 2015 financimi total ka qënë në vlerën e 544.2 miliardë lekë ose 37.7% e PBB, përkatësisht 410.4 miliardë lekë nëpërmjet burimeve të brendshme dhe 133.8 miliardë lekë nëpërmjet burimeve të huaja. Rreth 489.5 miliardë lekë kanë shërbyer për rifinancimin e borxhit ekzistues dhe pjesa tjetër për të mbuluar defiçitin buxhetor. Krahasuar me vitin e kaluar, rifinancimi i borxhit ekzistues ka qënë rreth 61.0 miliardë lekë më i lartë, kryesisht për shkak të rifinancimit të Eurobondit të emetuar në vitin 2010. (*Tabela 6*)

Megjithëse vlera për t'u financuar me borxh ka qënë relativisht e lartë, Ministria e Financave e ka menaxhuar me sukses duke përdorur në mënyrë efçente dhe në kohën e duhur burimet e brendshme dhe të huaja të financimit.

**Tabela 6:** *Financimi sipas instrumenteve të brendshme dhe të huaja*

Instrumente të Financimit	Dhj-2014		Dhj-2015	
	Vlera	%	Vlera	%
I. Financimi me Borxh të Brendshëm	429,391.9	88.9%	410,368.1	75.4%
i. Bono Thesari	337,433.2	69.8%	318,041.7	58.4%
ii. Obliqacione	91,958.7	19.0%	92,326.4	17.0%
II. Financimi me Borxh të Jashtëm	53,770.5	11.1%	133,808.1	24.6%
i. Mbështetje Buxhetore	30,508.6	6.3%	14,919.2	2.7%
ii. PBG	-	0.0%	34,897.5	6.4%
iii. Eurobond	-	0.0%	62,009.4	11.5%
iv. Kredi për Financim Projektsh	23,261.9	4.8%	21,982.0	4.0%
Total Financimi	483,162.5	100.0%	544,176.2	100.0%

Burimi: Ministria e Financave

Në tregun e brendshëm si burim financimi janë përdorur bonot e thesarit dhe obligacionet ku është synuar rritja e peshës së instrumenteve afatgjata dhe maturimi i instrumenteve afatshkurtra. Ky synim u realizua plotësisht pas emitimit të Eurobondit në muajin nëntor, i cili siguroi likuiditetin e nevojshëm dhe mundësoi tërheqjen nga tregu i brendshëm të titujve në vlerën e 51.7 miliardë lekë. Alternativat që mundësuan këtë tërheqje ishin procedura e tërheqjes parakohe (*buyback*) dhe maturimi pa rifinancim ose pjesërisht pa rifinancim i titujve. Nëpërmjet procedurës së *buyback* u tërhoqën nga tregu 19.65 miliardë lekë, kryesisht bono thesari dhe obligacione me maturitet të mbetur relativisht të ulët. Ndërkohë, nëpërmjet maturimeve u tërhoqën 32.0 miliardë lekë, nga të cilat 21.5 miliardë lekë nëpërmjet maturimeve të plota dhe 10.5 miliardë lekë nëpërmjet maturimeve të pjesshme.

Në tregun e huaj përveç instrumenteve të lartpërmendura (*PBG, Eurobond*) është përdorur mbështetja buxhetore në kuadër të marrëveshjes me FMN dhe BB për likuidimin e detyrimeve të prapambetura, si edhe disbursimi i kredive ekzistuese në kuadër të financimit të projekteve zhvillimore. Krahasuar me vitin e kaluar disbursimet për financimin e projekteve kanë qenë rreth 5.5% më të ulta. Sektorët që kanë përfituar më shumë kanë qenë transporti, energjia dhe ujësjellës kanalizime, përkatësisht me 31.8%, 28.7% dhe 20.1% të totalit të disbursimeve.

Gjatë këtij viti në kuadër të financimit të projekteve, Republika e Shqipërisë ka pasur marrëdhënie dinamike me kreditorë të tillë si: KfW, IDB, IDA, IBRD, BERZH, CEB, etj, duke nënshkruar projekte të reja që kapin vlerën e 526 milion Euro.

5. Zhvillimet e Tregut Primar të Titujve Shtetëror

5.1. Ecuria e ankandeve dhe kërkesa për titujt shtetërorë

Gjatë vitit 2015 janë organizuar në total 96 ankande për titujt qeveritarë, përkatësisht 53 ankande për bono thesari dhe 43 ankande për obligacione (*nga të cilat 5 janë rihapje*). Oferta e qeverisë nëpërmjet titujve qeveritare ka qënë 446.0 miliardë lekë, ndërkohë që kërkesa e investitorëve për titujt ka qënë relativisht më e lartë, rreth 498.5 miliardë lekë. Raporti i mbulimit (*Bid/Cover*) që vlerëson kërkesën për titujt shtetërorë ka qënë 1.12,



ndërkohë që në vitin 2014 ky raport ka qenë 1,06, megjithëse kërkesa për tituj ka qenë më e lartë. (Tabela 7)

Rritja e këtij treguesi gjatë vitit 2015 ka ardhur kryesisht si rezultat i uljes së ofertës në një shkallë më të lartë se kërkesa e tregut.

Përveç muajit janar, gusht dhe tetor ku Bid/Cover ka qenë përkatësisht 0.92, 0.91 dhe 0.97, në muajt e tjerë kërkesa e tregut ka qenë më e lartë se oferta e Ministrisë, duke reflektuar një normë mbulimi më të lartë se 1. Kërkesa e tregut për bonot e thesarit ashtu edhe për obligacionet ka qenë e njëjtë (1.12) duke mos reflektuar preferenca të veçanta për titujt shtetërorë.

Tabela 7: Treguesit e ecurisë së kërkesës për titujt shtetërorë

Periudha	Treguesi	Bono Thesari	Obligacione	Tituj Shtetërorë Gjithsej
2015	Nr ankandesh	53	43	96
	Shuma e kërkuar (në mln lekë)	380,224	118,364	498,588
	Shuma e ofruar (në mln lekë)	340,682	105,378	446,060
	Raporti i mbulimit	1.12	1.12	1.12


Burimi: Ministria e Financave

Aktorët kryesorë të kërkesës së përgjithshme për titujt qeveritarë gjatë vitit 2015 kanë qenë:

- Sistemi Bankar me 50.3 %
- Banka e Shqipërisë 20.1%
- Individët me 15.5%
- Institucione Financiare me 13.5%
- Institucione Jo Financiare me 0.7%

Gjatë vitit 2015 ka një diversifikim të kërkesës për titujt shtetërorë në drejtim të uljes së saj nga sistemi bankar dhe rritjes nga individët dhe institucionet jo financiare. Megjithatë, kërkesa ashtu si edhe gjatë vitit të kaluar vazhdon të dominohet në mbi 50% nga sistemi bankar. Gjatë vitit 2015 ka një rënie të kërkesës nga kjo kategori investitorësh me 1.96 pp, ndërkohë që brenda të njëjtës kategori, ka një rënie të diversifikimit për shkak të rritjes së përqendrimit të kërkesës me 12 pp në drejtim të tre bankave kryesore (*Raiffeisen Bank, BKT dhe Credins Bank*). Kërkesa në rënie nga ana e sistemit bankar është reflektuar më tepër në segmentin e instrumenteve me afat të gjatë maturimi.

Karakteristike për vitin 2015 është rritja e kërkesës nga ana e individëve si edhe deri diku e institucioneve jo financiare. Kërkesa në rritje nga ana e individëve ka ardhur si rezultat i normave më të favorshme që ofrojnë titujt shtetërorë krahasuar me depozitat bankare si edhe për shkak të informimit në rritje lidhur me procedurat e të investuarit në tituj shtetëror. Kërkesa në rritje nga individët është përqëndruar më tepër në drejtim të instrumenteve afatgjata.


Paraqitje Grafike 12: Kërkesa për titujt shtetërorë sipas pjesëmarrësve në ankande

Burimi: Ministria e Financave

5.2. Mbajtësit e borxhit

Gjatë vitit 2015 portofoli i borxhit sipas mbajtësve të tij pothuajse reflekton karakteristikat e kërkesës duke u shoqëruar me një rritje të diversifikimit në drejtim të uljes së peshës së borxhit të mbajtur nga sistemi bankar (përfshirë edhe Bankën e Shqipërisë) dhe rritjes së peshës së individëve dhe institucioneve të tjera financiare. (Paraqitje grafike 13)

Rritja e diversifikimit të mbajtësve minimizon rrezikun e rifinancimit pasi ul varësinë për t'u rifinancuar nga investitorë të caktuar. Nga ana tjetër diversifikimi i kërkesës shoqërohet me rritje të konkurrencës dhe për rrjedhojë ushtron edhe presion rënës mbi normat e interesit.

Paraqitje Grafike 13: Stoku i borxhit shtetëror sipas mbajtësve në tregun primar


Burimi: Ministria e Financave

5.3. Ecuria e normave të interesit

Gjatë gjithë vitit 2015 normat e interesit të titujve shtetërorë kanë pësuar rënie të vazhdueshme. Rënia e normave të interesit gjatë vitit 2015 i atribuohet faktorëve të mëposhtëm:

- Disponueshmëria relativisht e lartë e likuiditetit në sistemin bankar.
- Mungesa e investimeve alternative dhe kufizimi i kreditimit të sektorit privat nga sistemi bankar.
- Ulja e normës bazë të interesit në 1.75% nga Banka e Shqipërisë.
- Kërkesa jo shumë agresive për huamarrje të brendshme neto nga Qeveria.
- Rritje e kërkesës nga kategoria e Individëve për shkak të normave më të favorshme krahasuar me depozitat.

Paraqitje Grafike 14: Ecuria e normave të interesit të titujve shtetërorë në tregun primar



Burimi: Ministria e Financave

II. STRATEGJIA E MENAXHIMIT TË BORXHIT

1. Objektivat dhe Supozimet e Strategjisë Afatmesme 2016-2018

1.1. Udhëzime të përgjithshme në kuadër të huamarrjes

Strategjia Afatmesme e Menaxhimit të Borxhit ka si objektiv mbajtjen nën kontroll të ekspozimit ndaj risqeve si edhe krijimin e kushteve të përshtatshme për zhvillimin e tregut primar të titujve shtetërorë. Në këtë kuadër janë hartuar disa udhëzime, të cilat do të orientojnë huamarrjen e Qeverisë për periudhën 2016-2018:

- Ulja e ekspozimit ndaj rrezikut të rifinancimit duke e bazuar huamarrjen e brendshme kryesisht mbi instrumentet afatgjata. Në këtë kuadër, do të synohet rritja e volumeve të emetimit dhe rritja e frekuencës së emetimit (*nëpërmjet rihapjeve*) kryesisht për obligacionet 5, 7 dhe 10 vjeçare me qëllim uljen e fragamentimit të kurbës së yieldit dhe zhvillimin e kurbës së yieldit edhe në segmentin e instrumenteve afatgjata.
- Ulja e ekspozimit ndaj rrezikut të normave të interesit nëpërmjet kufizimit të borxhit të kontraktuar me norma interesi të lëvizshme dhe tërheqjes së një ose më shumë instrumenteve me norma interesi të lëvizshme.
- Kontraktimi i borxhit të huaj kryesisht në monedhën Euro ose në monedhat e përbëra.
- Dalja në tregjet ndërkombëtare të kapitalit mbi baza oportuniste.
- Vazhdimi i bashkëpunimit dhe mbajtja e marrëdhënieve të qëndrueshme me institucionet financiare ndërkombëtare për të përfutur nga produktet financiare që këto institucione ofrojnë.

1.2. Objektiva operacionale në kuadër të mbajtjes nën kontroll të risqeve të portofolit

Reduktimi i kostove për njësi të shërbimit të borxhit publik duke ruajtur raporte të pranueshme të rrezikut është objektivi i përgjithshëm i menaxhimit të borxhit. Me qëllim përmbushjen e këtij objektivi SAMB ka vendosur disa objektiva operacionale (*indikative*) për risqet kryesore të cilat paraqiten në tabelën 8.

Tabela 8: Objektiva për treguesit kryesorë të rreziqeve të portofolit

Tipi i rrezikut	Treguesi i Rrezikut	Treguesi 2015	Objektivi* (Fund 2018)
Rreziku i rifinancimit	KMM Borxhi Brendshëm	2.0 vite	Min. 2.2 vite
	KMM Borxhi Total	4.9 vite	Min. 4.7 vite
	Borxhi brendshëm i maturuar në 1 vit (% të totalit)	55.9%	Maks. 46.0%
	Borxhi total i maturuar në 1 vit (% të totalit)	31.6%	Maks. 26.0%
Rreziku i normave të interesit	KMR Borxhi Brendshëm	1.8	Min. 2.0
	KMR Borxhi Total	3.2	Min. 3.0
	Borxhi i brendshëm i rivlerësuar brenda 1 viti (% të totalit)	67.7%	Maks. 60.0%
	Borxhi total i rivlerësuar brenda 1 viti (% të totalit)	58.1%	Maks. 55.0%
Rreziku i kursit të këmbimit	Borxhi në monedhë të huaj (% të totalit)	48.5%	50.0%-55.0%

Burimi: Ministria e Financave

**Objektivat afatmesme paraqiten të rivlerësuar krahasuar me objektivat e strategjisë paraardhëse, për shkak të përmirësimit të ndjeshëm të treguesve të rrezikut (kryesisht treguesve të rrezikut të rifinancimit) përtej pritshmërive. Ndikim të lartë mbi ecurinë e treguesve ka pasur shtesa prej 150 milion Euro në emetimin e Eurobondit, e cila nuk ishte konsideruar në skenarin bazë të strategjisë afatmesme 2015-2017. Treguesit e mësipërm do të qendrojnë të pandryshuar dhe nuk do të përditësohen në periudhën afatmesme për aq kohë sa nuk do të ketë ndonjë ngjarje të paparashikuar dhe me ndikim të lartë.*



Në kuadër të menaxhimit të rrezikut të likuiditetit, në dhjetor 2015 është përfshirë në bazën rregullatore një Rezervë (*Cash buffer*) dhe pritët implementimi i saj.

Kjo praktikë do të bënte të mundur minimizimin e ankandëve të jashtëzakonshëm, të cilët mund të krijojnë konfuzion tek investitorët dhe presion rritës mbi normat e interesit, duke rritur në këtë mënyrë kostot e shërbimit të borxhit.

Nga ana tjetër, në funksion të uljes së ekspozimit ndaj rrezikut të likuiditetit në periudhën afatmesme janë edhe masat e marra në kuadër të uljes së rrezikut të rifinancimit të cilat kontribuojnë në ngadalësimin e ritmit të rritjes së detyrimeve që lindin nga shërbimi i borxhit (*pagesa principali dhe interesi*), duke e mbajtur të qëndrueshëm raportin me ritmin e rritjes së të ardhurave në buxhet. Megjithatë, këto masa nuk janë të mjaftueshme për uljen e rrezikut të likuiditetit dhe duhet patjetër që të shoqërohen me uljen e borxhit dhe konsolidim të të ardhurave në buxhet.

Në kuadër të menaxhimit të rrezikut operacional vlerësohet se gjatë periudhës afatmesme 2016-2018 duhen të realizohen veprimtaritë e mëposhtme:

- Përditësimi i sistemit të regjistrimit të të dhënave (*DMFAS*), dhe krijimi i bazës së integruar të të dhënave për borxhin e brendshëm dhe të jashtëm;
- Rishikimi dhe finalizimi i draft manualit të hartuar për Drejtorinë e Përgjithshme të Borxhit Publik;
- Shtimi i burimeve njerëzore në përputhje me strukturën e re të miratuar;
- Shtimi i mëtejshëm i kapaciteteve njerëzore nëpërmjet trajnimeve specifike.

1.3. Burimet e financimit për periudhën afatmesme 2016-2018

Në kuadër të shërbimit të borxhit ekzistues dhe në kuadër të plotësimit të nevojës për huamarrje, Strategjia Afatmesme e Menaxhimit të Borxhit (*SAMB*) ka analizuar dhe ka vlerësuar kushtet e tregut të brendshëm dhe të tregjeve ndërkombëtare të kapitalit, duke përcaktuar instrumentet financiare më të mundshme në dispozicion të vendit tonë.

Në tregun e brendshëm është mbajtur kontakt i vazhdueshëm, kryesisht me sistemin bankar me qëllim evidentimin e kërkesës kundrejt instrumenteve financiare shtetërore dhe shkallën e ekspozimit kundrejt instrumenteve me afat të gjatë maturimi.

Ndërkohë, edhe me tregun e jashtëm është mbajtur vazhdimisht kontakt me qëllim evidentimin e kushteve kundrejt të cilave investitorët e huaj janë të gatshëm të kreditojnë vendin tonë.

Për sa më sipër, SAMB vlerëson se në periudhën afatmesme 2016-2018 shteti Shqiptar do të jetë në gjendje që shfrytëzojë alternativat e financimit si më poshtë:

1.3.1. Në tregun vendas

- Bono thesari;
- Obligacione;

Në tregun vendas, likuiditeti i sistemit bankar në nivele të kënaqshme, si edhe perceptimi jo i lartë i rrezikut të kreditit nga ana e investitorëve, i jep mundësinë shtetit Shqiptar të ri-

financojë borxhin aktual dhe defiçitin e brendshëm nëpërmjet instrumenteve të sipër renditura.

Gjatë vitit 2016 investitorët kryesorë (*sistemi bankar*) për shkak të orientimit të bankave mëma, si dhe në kuadër të kufizimeve lidhur me raportet e likuiditetit, barrës së kapitalit dhe ekspozimit ndaj borxhit sovran do të tentojnë më së shumti të orientohen drejt bonove të thesarit. Gjithsesi, orientimi i sistemit bankar drejt titujve afatshkurtër do të kompensohet nga rritja e kërkesës së individëve dhe orientimi i tyre më së shumti drejt titujve afatgjatë.

1.3.2. Në tregjet ndërkombëtare

- Eurobond
- Garanci Pjesore e lëshuar nga Banka Botërore (PBG). Konsiston në garantimin e pjesshëm nga ana e BB-së të një kredie tregtare nga tregjet ndërkombëtare dhe që mundëson një kosto më të favorshme krahasuar me atë të tregut.
- Kredi për financim projektsh. Në këtë grup futen të gjitha huatë në formën e kredive që përdoren për financimin e projekteve zhvillimore, të cilat janë përcaktuar si prioritare nga ana e Qeverisë, me qëllim zhvillimin e mëtejshëm ekonomik të vendit. Kryesisht do të jenë të disponueshme kredi me norma interesi tregtare por me jetgjatësi relativisht të lartë.
- Mbështetje buxhetore në kuadër të marrëveshjes me institucionet ndërkombëtare financiare (BB dhe FMN)

1.4. Zhvillimet dhe supozimet makroekonomike bazë për periudhën afatmesme 2016-2018


Në këtë nënkapitull paraqiten disa nga zhvillimet aktuale, si edhe supozimet kryesore makroekonomike në të cilat bazohet SAMB në skenarin bazë. Më poshtë paraqiten projeksionet e treguesve makroekonomikë në periudhën afatmesme duke supozuar se nuk do të ketë goditje mbi këta tregues dhe për rrjedhojë as ndryshime të parametrave të tyre.

Këto supozime janë faktorë kyç dhe ndryshimi i tyre nga skenari bazë mund të ketë ndikim mbi realizimin e objektivave strategjikë të përcaktuara në SAMB, mbi rritjen e financimit dhe për rrjedhojë edhe rritjen e kostos së borxhit. Në këtë kontekst, është shumë e rëndësishme që bilanci primar të qëndrojë në të njëjtat nivele, të ardhurat në buxhet të stimulohen nëpërmjet konsolidimit të politikave fiskale, uljes së informalitetit, etj; rritja ekonomike të stimulohet nëpërmjet rritjes së prodhimit vendas dhe investimeve të huaja; qëndrueshmëria e monedhës të garantohet nëpërmjet politikave monetare të shëndosha dhe të shoqërohet me përmirësim të bilancit të pagesave.

Përgjatë vitit 2015, ekonomia në vend vijoi të zgjerohet, e mbështetur kryesisht nga rritja e investimeve dhe nga gjallërimi i aktivitetit në sektorin e shërbimeve. Bazuar në vlerësimet paraprake të Produktit të Brendshëm Bruto nga INSTAT, rritja reale për të gjithë vitin 2014 rezultoi 2.1 %, ndërsa për vitin 2015 rritja u përshpejtua në 2.6%. Këto të dhëna, sinjalizojnë se aktiviteti ekonomik në vend po ndjek një trajektore pozitive zhvillimi, ndërkohë që

analizat dhe parashikimet për periudhën afatmesme sugjerojnë se ekonomia shqiptare do të vazhdojë të shënojë ritme progresive rritjeje deri në 4.2%.⁵ (Paraqitje grafike 15)


Paraqitje Grafike 15: Vlerat historike dhe projeksionet e rritjes ekonomike (2016-2018)



Burimi: Ministria e Financave

Defiçiti buxhetor do të shoqërohet me rënie, pasi parashikimet flasin për ritme rritje më të larta në krahun e të ardhurave krahasuar me ritmet e rritjes në krahun e shpenzimeve. Ndërkohë, duke filluar nga viti 2016 defiçiti primar është planifikuar të jetë pozitiv. (Paraqitje grafike 16)

Paraqitje Grafike 16: Treguesit fiskal (2016-2018)



Burimi: Ministria e Financave

Pjesë e supozimeve krahas atyre të ilustruara në tabelën 9 janë edhe normat e interesit të instrumenteve të tregut të brendshëm dhe atyre të tregut të jashtëm. Projeksionet e normave të interesit për tregun vendas janë realizuar duke marrë parasysh politikat monetare të Bankës së Shqipërisë dhe rrezikun e perceptuar nga ana e investitorëve kundrejt instrumenteve financiare vendase. Ndërkohë, për sa i përket normave të interesit të tregjeve ndërkombëtare janë marrë parasysh parashikimet e institucioneve financiare si: Banka Qendrore Europiane, BB, FMN etj.

Parashikimet e normave të interesit për periudhën afatmesme flasin për një rritje graduale (duke filluar nga viti 2017), por gjithsesi për një rritje të moderuar, nën mesataren historike. Nivel më të lartë rritjeje pritet që të ketë në segmentin e instrumenteve afatshkurtra (*bonove të thesarit*) si edhe në segmentin e instrumenteve me norma të lëvizshme, spread-i i të cilave

⁵ Referuar Kuadrit Makroekonomik miratuar me VKM Nr.80, datë 03.02.2016

është subjekt i ndryshimit në normat e bonove të thesarit 12 mujore. Gjatë vitit 2016, në tregun e brendshëm pritet që të ketë një qëndrueshmëri të normave të interesit duke marrë parasysh politikat lehtësuese të Bankës së Shqipërisë për rritjen e kreditimit. Ndërkohë, në tregun e jashtëm gjatë vitit 2016 parashikohet një rritje e moderuar e normave, kryesisht në segmentin e instrumenteve me norma interesi tregtare.

Kursi i këmbimit të monedhës vendase kundrejt monedhës Euro që është dhe monedha me peshën më të lartë në portofol pritet që të jetë i qëndrueshëm, por për efekte të diferencimit të risqeve të strategjive të analizuara është supozuar një rritje graduale deri në 146 LEK për EUR në fund të vitit 2018.

Politikat monetare të Bankës së Shqipërisë do të jenë stimuluese në kuadër të mbështetjes së rritjes ekonomike dhe në përputhje me objektivin primar për ruajtjen e stabilitetit të çmimeve. Në vitet në vijim inflacioni i targetuar nga BSH do të luhatet në intervalet 2.6%-3%.⁶

Sektori bankar në vend paraqet nivel të lartë të likuiditetit dhe është i mirëkapitalizuar. Në periudhën afatmesme pritshmëritë janë pozitive në kuadër të uljes së kredive që nuk performojnë mirë si dhe rritjes së kreditimit ndaj sektorit privat.

Tabela 9: Supozimet makroekonomike në periudhën afatmesme

Treguesit	2015	2016	2017	2018
PBB (miliardë lekë)	1,444.7	1,530.6	1,637.2	1,760.2
Rritja reale e PBB (%)	2.6	3.4	3.9	4.2
Bilanci i përgjithshëm (% ndaj PBB)	-4.0	-2.3	-1.4	-0.5
Bilanci primar (% ndaj PBB)	-1.23	0.56	1.52	2.41
Kursi i këmbimit (mesatar) Lek / Euro	139.66	141.93	144.00	146.00
Inflacioni (mesatar %)	1.8	2.3	2.7	3.0

Burimi: Ministria e Financave

1.5. Vlerësime referuar borxhit ekzistues, tregjeve të instrumenteve financiare dhe faktorëve makroekonomikë

Ekspozimi ndaj rrezikut të rifinancimit dhe rrezikut të normave të interesit në tregun e brendshëm janë burimet kryesore të rrezikut në portofolin e borxhit shtetëror. Ekspozimi ndaj rrezikut të kursit të këmbimit megjithëse është relativisht i lartë për shkak të rritjes së borxhit në monedhë të huaj dhe për shkak të portofolit jo shumë të diversifikuar, tenton të zbutet. Kjo bazohet në faktin që mbi 70% e borxhit të huaj është e denominuar në monedhën Euro, e cila ka një volatilitet relativisht të ulët kundrejt monedhës vendase edhe është e targetuar nga politikat monetare të Bankës së Shqipërisë, për shkak të aspiratave të vendit për t'u integruar në Bashkimin Europian.

⁶ Referuar informacionit të marrë nga Banka e Shqipërisë, publikuar në datën 03.02.2016, https://www.bankofalbania.org/web/NJOFTIM_PER_SHTYP_7433_1.php?kc=0,26,0,0,0



Kushtet aktuale të tregjeve e lejojnë vendin të marr hua në tregun e brendshëm ashtu edhe në atë të huaj kryesisht nëpërmjet instrumenteve të përmendura në paragrafin 1.3.

Tregu i brendshëm është më i lehtë për tu aksesuar, kërkon më pak procedura dhe eviton ekspozimin ndaj rrezikut të kursit të këmbimit.

Megjithatë, huazimi i vazhdueshëm në tregun e brendshëm ka implikime, të cilat rrjedhin nga niveli relativisht i lartë i borxhit që rifinancon qeveria në harkun kohor të një viti (*mbi 350 miliardë lekë*), nga baza e ngushtë e investitorëve që përbëhet në më shumë se 58% nga sistemi bankar dhe nga tregu jo plotësisht i zhvilluar i instrumenteve financiare, për shkak të mungesës së një tregu sekondar të mirfilltë. Duke marrë parasysh këta faktorë rezulton se kërkesa e lartë për financim nga ana e qeverisë në tregun e brendshëm shoqëruar me nivelin e lartë të kredive që nuk performojnë mirë mund të uli kreditimin e sektorit privat, i cili është faktor mjaft i rëndësishëm për sa i përket rritjes ekonomike të vendit, uljes së papunësisë strukturore, si edhe rritjes së produktivitetit dhe konkurrueshmërisë në rajon e më gjerë. Nga ana tjetër, rritja progresive e borxhit që duhet shërbyer në monedhë të huaj është në nivele të konsiderueshme dhe siguri i valutës në tregun e brendshëm valutë është i kufizuar dhe mund të krijojë implikime në ruajtjen e qëndrueshmërisë së kursit të këmbimit të monedhës vendase kryesisht kundrejt monedhës Euro.

Tregu i jashtëm ofron burime të palimituara të financimit dhe është lehtësisht i aksesueshëm nga Shteti Shqiptar. Sigurimi i financimit nëpërmjet burimeve të huaja është një alternativë shumë e mirë për të mos ezauruar burimet e brendshme dhe për të stimuluar kreditimin ndaj sektorit privat.

Megjithatë edhe huamarrja në tregjet e huaja mund të ketë implikime që lidhen me faktorë që janë jashtë kontrollit dhe influencës së politikave fiskale dhe monetare të vendit tonë, të tilla si normat e interesit dhe kursi i këmbimit që varen kryesisht nga politikat fiskale të vendeve të tjera dhe politikat monetare të BQE dhe Rezervës Federale. Këta faktorë mund të përshkallëzojnë rritjen e kostove të borxhit, zgjerimin e defiçitit dhe si rrjedhojë edhe rritjen e pavullnetshme të borxhit. Nga ana tjetër, rritja e stokut të borxhit kur nuk shoqërohet me rritje të eksporteve ose rezervave valutore mund të vërë vendin në vështirësi për të likuiduar detyrimet në valutë, duke rrezikuar qëndrueshmërinë e monedhës vendase dhe indikatorëve të tjerë makroekonomikë.

1.6. Strategjia bazë e financimit

Duke iu referuar vlerësimeve të sipërpërmendura (*nënkapitulli 1.5.*), analizës kosto/rrezik (*Aneksi 1*), objektivave për uljen e ekspozimit të portofolit ndaj risqeve kryesore (*Aneksi 1*), si dhe shkallës së zhvillimit të tregut që ofron secila nga strategjitë e alternative të financimit, rezulton se strategjia e bazuar në shtimin e peshës së titujve afatgjatë në portofol dhe në reduktimin e segmentimit të tregut të brendshëm (*Strategjia 3, aneksi 1*) është strategjia më e përshtatshme.

Kjo strategji do të fokusohet në dy drejtime kryesore: **a)** në drejtim të uljes së ekspozimit ndaj rreziqeve dhe **b)** në drejtim të zhvillimit të tregut primar të titujve shtetërorë.

Në kuadër të uljes së rrezikut të rifinancimit dhe atij të normave të interesit, në tregun e brendshëm do të synohet reduktimi i financimit me instrumente afatshkurtra dhe rritja e përqëndrimit të financimit kryesisht në segmentin e obligacioneve 7 dhe 10 vjeçare me norma interesi fikse.

Në kuadër të zhvillimit të tregut primar të titujve shtetërorë në periudhën afatmesme do të synohet:

- Reduktimi i segmentimit të tregut të titujve shtetërorë nëpërmjet tërheqjes graduale nga tregu të obligacionit 3 vjeçar si edhe obligacioneve 7 dhe 10 vjeçare me norma interesi të ndryshueshme, pasi nga analizat e realizuara rezulton se numri i instrumenteve financiare të emetuara në tregun e brendshëm është relativisht i lartë krahasuar me shkallën e zhvillimit të tregut që zotëron vendi, ndërkohë që disa instrumente konkurojnë njëra tjetrën duke fragmentuar kërkesën, duke mos lejuar në këtë mënyrë krijimin e një kurbe yieldi të qëndrueshme dhe duke vështirësuar procesin e zbulimit të çmimit (*price discovery*) për investitorët.
- Krijimi i madhësive benchmark për titujt shtetërorë afatgjatë duke përdorur rihapjen më të shpeshtë të ankandëve ekzistuese dhe duke evituar emetimin e ankandëve të reja.
- Konsultimi i vazhdueshëm dhe i rregullt me aktorët kryesorë të tregut në mënyrë kolektive dhe individuale për të shkëmbyer informacion lidhur me planet e financimit të Qeverisë dhe planet e tyre për të investuar në tituj shtetërorë.
- Rritja e transparencës në publikimin dhe përditësimin e rregullt të informacionit për emetimin e titujve shtetërorë.
- Zgjerimi i bazës së investitorëve duke i hapur rrugën zhvillimit të tregut sekondar nëpërmjet bashkëpunimit me BSH, AMF dhe aktorëve të tjerë potencial të tregut.

Në aspektin e kostos kjo strategji është relativisht e kushtueshme pasi përqëndron financimin tek titujt afatgjatë. Megjithatë, duke marrë parasysh normat e interesit në nivelet minimale historike rezulton se është një moment mjaft i përshtatshëm për zbatimin e kësaj strategjie me një kosto sa më të ulët.

1.6.1. Kufizimet

Duke marrë parasysh shkallën e zhvillimit të tregut të brendshëm në të cilën përfshihen baza e investitorëve, likuiditeti dhe shkalla e ekspozimit ndaj instrumenteve afatgjata, rezulton se tregu i brendshëm i instrumenteve financiare nuk është shumë i zhvilluar për shkak të mungesës së një tregu sekondar të mirfilltë dhe bazës së kufizuar të investitorëve të përbërë kryesisht nga sistemi bankar. Likuiditeti që zotëron sistemi bankar është në nivele të kënaqshme, por synimet janë për mbajtjen e qëndrueshme të ekspozimit ndaj borxhit sovran dhe kryesisht ndaj borxhit sovran afatgjatë. Referuar këtyre kufizimeve rezulton se *strategjia 3* mund të hasë vështirësi në implementim për aq kohë sa financimi i brendshëm paraqitet në rritje. Megjithatë, në raste të tilla është menduar që presioni në rritje i financimit të brendshëm të reduktohet nëpërmjet daljes në tregjet ndërkombëtare të kapitalit (*në rast se kushtet e tregjeve janë të përshtatshme*) ose nëpërmjet instrumenteve financiare të kreditimit

të ofruara nga institucionet ndërkombëtare si BB dhe FMN. Pavarësisht mundësisë për shtim të financimit të huaj në momente të caktuara, shkalla e ekspozimit ndaj borxhit të denominuar në monedhë të huaj do të qëndrojë brenda objektivit të paraqitur në kapitullin 1.2.

1.6.2. *Financimi*

Referuar skenarit bazë, sipas të cilit nuk do të jetë e nevojshme shtesa e financimit të huaj për të mbështetur zbatimin e strategjisë, financimi i brendshëm për periudhën 2016-2018 do të jetë në nivelin e 90%-92% të totalit të financimit, ndërkohë që financimi nëpërmjet titujve afatgjatë do të synojë të rritet deri në 30%-32% në vitin 2018, nga 17% që vlerësohet në vitin 2015.

Financimi i huaj do të jetë në nivelin 8-10% të totalit të financimit dhe do të mbështetet kryesisht tek financimi i projekteve ekzistuese si edhe i projekteve të reja zhvillimore për të cilat Qeveria është angazhuar, ndërkohë që në vitin 2016 financimi i huaj do të plotësohet edhe nga mbështetja buxhetore e akorduar në kuadër të marrëveshjes me partnerët ndërkombëtarë si BB dhe FMN. (Tabela 10)

Tabela 10: *Financimi bruto në vlerë relative sipas instrumenteve*

Financimi	Instrumente të Financimit	2015	2016	2017	2018
I Brendshëm	i. Bono Thesari	58.4%	63.0%	62.0%	60.0%
	ii. Obliagcione	17.0%	27.0%	30.0%	32.0%
	Total	75.4%	90.0%	92.0%	92.0%
I Jashtëm	i. Financim Projektsh	4.0%	6.5%	8.0%	8.0%
	ii. Mbeshtetje Buxhetore	9.1%	3.5%	0.0%	0.0%
	iii. Eurobond	11.5%	0.0%	0.0%	0.0%
	Total	24.6%	10.0%	8.0%	8.0%

Burimi: *Ministria e Financave*

ANEKS I

ANALIZA E STRATEGJIVE ALTERNATIVE TË FINANCIMIT

Analiza e strategjive alternative të financimit është realizuar duke marrë parasysh analizën sasiore (kosto/rrezik), analizën cilësore (nënkapitulli 1.5.) si edhe shkallën e zhvillimit të tregut që ofron secila nga strategjitë e financimit.

1. Metodologjia e përdorur në analizën sasiore**Modeli i përdorur**

Analiza sasiore (*kosto/rrezik*) e strategjive alternative të financimit është realizuar bazuar në përdorimin e modelit analitik për Strategjinë Afatmesme të Menaxhimit të Borxhit (MTDS analytical tool) i konceptuar nga Banka Botërore dhe FMN për t'i ardhur në ndihmë Menaxhimit të Borxhit të vendeve në zhvillim. Modeli i përdorur është një model determinues, output-et e të cilit varen nga vlerat dhe gjendja fillestare e parametrave (parametrat ekzistues të borxhit). Modeli është i ndërtuar në mënyrë të tillë që të projektojë flukset e borxhit në periudhën afatmesme në varësi të inputeve që i injektohen modelit në secilën prej strategjive. Outputi i modelit është vlerësimi i koston dhe rrezikut përkatësisht për secilën prej strategjive.

Input-et

Inputet kryesore të përdorura në model janë **i)** flukset e borxhit (*interesat dhe principali*) ekzistues në fundin e vitit 2015, **ii)** variablat e supozimeve makroekonomike (*defiqiti primar, PBB, rezervat valutore, eksportet*), të cilat orientojnë nevojat për financim të vendit dhe paraqesin raporte të caktura të borxhit, **iii)** strategjitë alternative të financimit, **iv)** variablat financiare (*normat e interesit dhe kursi i këmbimit*).

Inputet për flukset e borxhit ekzistues injektohen në model pasi paraprakisht grupohen në grupe me karakteristika rreziku të ngjashme. Në rastin konkret flukset e borxhit ekzistues janë grupuar në 15 grupe, përkatësisht 9 grupe për instrumentet në monedhë vendase (*borxhi i brendshëm*) dhe 6 grupe për instrumentet në monedhë të huaj (*borxhi i jashtëm*).

Strategjitë alternative të financimit dallojnë nga njëra tjetra nga **i)** raporti i financimit ndërmjet borxhit të brendshëm dhe të jashtëm dhe **ii)** dhe raportet e financimit ndërmjet grupeve me karakteristika rreziku të ngjashme përkatësisht për borxhin e brendshëm dhe të jashtëm.

Output-et

Outputi i modelit të përdorur konsiston në kuantifikimin e koston dhe rrezikut për secilën strategji të marrë parasysh. Modeli ilustron rezultatet që ka secila nga strategjitë e marra në shqyrtim nën efektin e skenarëve të variablave financiare, si edhe jep informacion për risqet

që do të mbart struktura e borxhit në fund të periudhës afatmesme për secilën nga strategjitë e konsideruara.

Skenarët

- i) Skenari bazë përcaktohet si skenari me probabilitetin më të lartë të ndodhisë (*skenari më shumë i pritshëm*) për secilën nga strategjitë dhe përdoret për të përcaktuar kostot (borxhi/PBB dhe interesa/PBB, etj).
- ii) Skenarët e stresit përcaktohen si skenarë alternativë dhe krijohen nga goditjet që aplikohen mbi variablat financiare (normat e interesit dhe kursin e këmbimit). Devijimi i kostove në skenarët e stresit nga kostot e skenarit bazë të secilës strategji përcakton rrezikun. Teorikisht mund të aplikohet një pafundësi skenarësh stresi, ndërkohë që në rastin konkret janë aplikuar dy skenar stresi për normat e interesit, dy skenar stresi për kursin e këmbimit dhe një skenar stresi me goditje të normave të interesit dhe kursit të këmbimit njëkohësisht. Për skenarët e stresit të normave të interesit janë aplikuar **a)** goditje uniforme për të gjitha instrumentet financiare (zhvendosje paralele e kurbës së yieldit) dhe **b)** goditje e diversifikuar (zhvendosje dhe rritje të pjerësisë së kurbës së yieldit).

Kohështirja

Kohështirja e analizës është marrë 5 vite me qëllim që secila nga strategjitë e konsideruara të jap efektet e saj sa më të dukshme mbi strukturën dhe risqet që do të mbart borxhi. Në periudha më të shkurtra kohore diferencimi i borxhit sipas secilës prej strategjive të aplikuara nuk është evident dhe e bën më të vështirë evidentimin e kostove dhe risqeve të mbartura.

2. Strategjitë alternative të financimit

Referuar instrumenteve të financimit në dispozicion si edhe objektivave për uljen e ekspozimit ndaj rrezikut të rifinancimit dhe rrezikut të normave të interesit, menaxhimi i borxhit ka vlerësuar katër strategji të mundshme financimi, nga të cilat tre konsistojnë në menaxhimin e instrumenteve financiare të tregut të brendshëm dhe një në rritjen e financimit të huaj.

Strategjia 1 bazohet kryesisht në rifinancimin e instrumenteve ekzistuese dhe sigurimin e financimit të brendshëm në mbi 70% kryesisht nëpërmjet instrumenteve afatshkurtra. Kjo strategji ka një kosto relativisht të ulët në skenarin bazë dhe një ekspozim relativisht të ulët ndaj rrezikut të kursit të këmbimit. Nga ana tjetër kjo strategji karakterizohet nga rreziku i lartë rifinancimit dhe i normave të interesit duke mos garantuar përmirësim të strukturës së borxhit të brendshëm.

Strategjia 2 synon të reduktojë segmentimin e tregut të brendshëm të instrumenteve financiare nëpërmjet tërheqjes nga tregu të obligacionit 3 vjeçar dhe obligacioneve 7 dhe 10 vjeçare me norma interesi të ndryshueshme. Në aspektin e koston dhe risqeve kjo strategji



është relativisht e ngjashme me *strategjinë 1*, por në dallim ofron avantazhe në kuadër të zhvillimit të tregut të instrumenteve financiare si edhe rritjes së qëndrueshmërisë së normave të interesit në terma afatgjata. Nuk ofron përmirësim të dukshëm përsa i përket uljes së ekspozimit ndaj rrezikut të refinancimit dhe rrezikut të normave të interesit.

Strategjia 3 gjithashtu synon të reduktojë segmentimin e tregut të instrumenteve financiare nëpërmjet tërheqjes nga tregu të obligacionit 7 dhe 10 vjeçar me norma interesi të ndryshueshme, por në dallim nga *strategjia 2* synon reduktimin e financimit me instrumente afatshkurtra dhe rritjen e përqendrimit të financimit kryesisht në segmentin e obligacioneve 7 dhe 10 vjeçare me norma interesi fikse. Në aspektin e koston është një strategji më e kushtueshme se dy strategjitë e para, por ka avantazh të theksuar përsa i përket përmirësimit të strukturës së borxhit në kuadër të uljes së ekspozimit ndaj rrezikut të refinancimit dhe rrezikut të normave të interesit.

Strategjia 4 synon uljen e presionit të huamarrjes në tregun e brendshëm nëpërmjet rritjes së huamarrjes në tregun e jashtëm, nga 10 % në rreth 20-25% të totalit të huamarrjes. Huamarrja në tregun e jashtëm mund të konsistoj në daljen periodike në tregjet ndërkombëtare të kapitalit ose në kredinë pjesërisht të garantuar nga Banka Botërore (PBG). Ulja e presionit për financim në tregun e brendshëm mund të krijoj kushte të përshtatshme për përmirësimin e strukturës së borxhit të brendshëm nëpërmjet kalimit nga instrumentet afatshkurtra drejt instrumenteve afatgjata. Gjithashtu, kjo strategji mund të shërbejë edhe si katalizator për rritjen e kreditimit të sektorit privat. Në aspektin e koston kjo strategji është relativisht e kushtueshme (në rastin e daljes në tregjet ndërkombëtare të kapitalit), por e përmirëson portofolin e borxhit konsiderueshëm në aspektin e ekspozimit ndaj rrezikut të refinancimit dhe rrezikut të normave të interesit, ndërkohë që e rrit ekspozimin ndaj rrezikut të kursit të këmbimit më shumë nga gjithë strategjitë e tjera.

Kjo strategji e limiton zhvillimin e tregut të brendshëm të titujve pasi ulja e financimit të brendshëm nuk krijon shumë hapësira për krijimin e madhësive benchmark.

Një opsion i dytë i kësaj strategjie do të ishte edhe huazimi në tregun e huaj për qëllime të menaxhimit të detyrimeve ekzistuese, duke marrë në konsideratë normat e interesit relativisht të ulta. Ky opsion konsiston në zëvendësimin e një pjese të borxhit të huaj ekzistues (shtetëror ose të garantuar) me një borxh të ri më pak të kushtueshëm dhe me terma më optimale përsa i përket risqeve. Ky opsion do të shoqërohej me reduktim të koston dhe nuk do kishte asnjë efekt përsa i përket ekspozimit ndaj kursit të këmbimit, por nga ana tjetër do të kishte efikasitet më të ultët përsa i përket përmirësimit të rrezikut të refinancimit dhe rrezikut të normave të interesit krahasur me opsionin e parë të kësaj strategjie.

3. Analiza kosto/rrezik dhe ekspozimi ndaj rreziqeve

Në terma të koston dhe rrezikut analiza demonstron se në skenarin bazë strategjitë alternative të cilat e përqëndrojnë financimin më tepër tek instrumentet afatgjata (*strategjia 3 dhe strategjia 4*) ofrojnë një përmirësim të ekspozimit ndaj rrezikut të refinancimit dhe përmirësim në profilin e amortizimit të borxhit, në ndryshim nga *strategjia 1 dhe strategjia 2* të cilat bazohen kryesisht në financimin nëpërmjet instrumenteve afatshkurtra. Ndërkohë, rritja e financimit nëpërmjet instrumenteve afatgjata shoqëruar me përqendrim të financimit kryesisht në instrumentet me norma interesi fikse (*strategjia 3 dhe strategjia 4*) sjell






përrmirësim të dukshëm në treguesit e rrezikut të normave të interesit (*KMR dhe instrumentet që rivlerësohen në % të totalit*). Nga ana tjetër, nga analiza rezulton se zgjatja e jetgjatësisë së portofilit shoqërohet me shtesë të kostos. Në këtë aspekt *strategjia 3 dhe 4* janë më të kushtueshme duke pasur rritje në pagesat për interesa të borxhit. Gjithashtu nga analiza rezulton se tre strategjitë e para kanë një ekspozim pothuajse të ngjashëm ndaj rrezikut të kursit të këmbimit dhe relativisht më të ulët krahasuar me *strategjinë 4* e cila karakterizohet nga rritja e financimit të huaj.

Tabela 1: Indikatorët e ekspozimit ndaj rreziqeve (Fund 2020)

Indikatorët e Rrezikut		2015	Fund 2020			
		Fakt	S1	S2	S3	S4
Rreziku i Rifinancimit	Borxh që maturohet brenda 1 viti (% të totalit)	31.6	31.0	31.4	24.2	24.5
	KMM Borxhi Jashtëm (në vite)	8.0	6.5	6.5	6.5	6.0
	KMM Borxhi Brendshëm (në vite)	2.0	2.0	2.0	2.7	2.4
	KMM Borxhi Gjithsej (në vite)	4.9	4.1	4.1	4.4	4.3
Rreziku i Normave të Interesit	KMR (në vite)	3.2	2.5	2.7	3.0	2.8
	Borxhi Gjithsej i rivlerësuar në 1 vit (% të totalit)	58.1	62.8	60.5	53.1	54.0
	Borxhi Gjithsej me interesa fikse (% of total)	48.6	45.9	48.1	55.8	54.0
Rreziku i Kursit të Këmbimit	Borxhi Gjithsej në monedhë të huaj (% të totalit)	48.3	47.1	47.4	43.3	52.9

Paraqitje Grafike1: Raportet kosto/rrezik





ANEKS II


ANALIZA E NDJESHMËRISË NDAJ RREZIQEVE

Rritja e stokut të borxhit të huaj deri 55% e bën borxhin të ndjeshëm ndaj luhatjeve të kursit të këmbimit.

Një zhvlerësim i mundshëm i monedhës vendase kundrejt monedhës EUR ose ndaj monedhave të tjera, të cilat janë pjesë përbërëse e portofolit të borxhit do të kishte efekte rritëse mbi raportin e stokut të borxhit ndaj PBB, *(pavarësisht mbajtjes së njëjtë të stokut në vlerë nominale)* dhe në të njëjtën kohë efekte financiare rritëse që rrjedhin nga shërbimi i borxhit.

Më konkretisht, një zhvlerësim i monedhës vendase prej 15% ndaj të gjitha monedhave që përbëjnë portofolin e borxhit të jashtëm do e rriste nivelin e borxhit në raport me PBB deri në 5 pp dhe në të njëjtën kohë shërbimin e borxhit/PBB deri në 11 pb ose 1.9 miliard lekë.

Paraqitje Grafike1: *Ndjeshmëria e nivelit të borxhit në raport me PBB ndaj luhatjeve të kursit të këmbimit*





Në rastin e zhvlerësimit të monedhës vendase me 15% vetëm kundrejt monedhës EUR dhe jo ndaj monedhave të tjera, atëherë efektet do të ishin më të ulta, përkatësisht rritje e nivelit të borxhit në raport me PBB deri në 3.2 pp dhe rritje e shërbimit të borxhit deri në 1.25 miliard lekë. (Paraqitje grafike 1)

Nga ana tjetër, rritja e ekspozimit të borxhit ndaj monedhës së huaj mund të rrisë ndjeshmërinë ndaj faktorëve të jashtëm duke ndikuar në uljen e qëndrueshmërisë së borxhit dhe si rrjedhojë të shoqërohet me një ulje në vlerësimin e kreditit nga kompanitë e vlerësimit. Një ulje në vlerësim do të shkaktonte rritje të kostos së huamarrjes për shkak të rritjes së primit të rrezikut, duke u shoqëruar me shkurtime të shpenzimeve qeveritare në buxhet ose rritje të deficitit. Në të dy këto raste rezultati i pritshëm është një rritje e mëtejshme e borxhit të shkaktuar nga rritja e deficitit ose nga kontraktimi i rritjes ekonomike për shkak të investimeve të munguara.

Një rrezik tjetër i cili ka efekte të konsiderueshme mbi nivelin dhe kryesisht mbi shërbimin e borxhit është edhe rreziku i normave të interesit të tregut të brendshëm dhe atij të huaj. Rritja e normave të interesit në tregun vendas dhe atë të huaj përkatësisht me 1 dhe 2 pp do të kishte efektet të cilat ilustrohen grafikisht si më poshtë:

Paraqitje Grafike2: Ndjeshmëria e shërbimit të borxhit ndaj luhatjeve të normave të interesit





ANEKS III

FJALOR TEKNIK

Benchmark – Një instrument i tregtueshëm në frekuenca të shpeshta kohore dhe në vlera të konsiderueshme. Norma e këtij instrumenti shërben si referencë për vlerësimin e normave të instrumenteve të tjera (*P.sh. Bono Thesari 12- mujore*).

Buyback – është forma e ndërsjelltë e emetimit të titujve shtetërorë e cila të lejon që të maturosh përpara kohe një titull shtetëror.

KMM – Tregues i rrezikut të ri-financimit për borxhin. KMM është periudha mesatare e shprehur në ditë ose në vite, që i duhet portofolit të borxhit për t'u maturuar. Sa më larg në kohë të jetë e projektuar data e maturimit të një instrumenti, aq më i ulët është rreziku i ri-financimit dhe aq më e lartë është vlera e këtij treguesi. KMM për instrumentet financiarë të borxhit përlogaritet sipas formulës së mëposhtme:

$$KMM = \frac{\sum_{t \in T} \frac{N_t}{(1+r)^t}}{\sum_{t \in T} \frac{1}{(1+r)^t}}$$

Nga ku:

t – data e maturimit;

T – bashkësia e të gjitha datave të maturimit;

N_t – Vlera nominale që do të paguhet në datën t .

KMR – Tregues i rrezikut të normave të interesit për borxhin. Jep informacion lidhur me ekspozimin e portofolit të borxhit kundrejt ndryshimit të normave të interesit. KMR interpretohet si koha mesatare (në vite) që i duhet portofolit të borxhit për të ripërcaktuar normën e interesit. Sa më e madhe të jetë sasia e instrumenteve afatshkurtër dhe sasia e instrumenteve me norma interesi të ndryshueshëm në portofolin e borxhit, aq më i madh është rreziku i normave të interesit dhe aq më i vogël ky tregues dhe anasjelltas. KMR për instrumentet financiarë të borxhit përlogaritet sipas formulës së mëposhtme:

$$KMR = \frac{\sum_{t \in T} \frac{N_t}{(1+r)^t} + \sum_{t \in T} \frac{N_t}{(1+r)^t}}{\sum_{t \in T} \frac{1}{(1+r)^t} + \sum_{t \in T} \frac{1}{(1+r)^t}}$$

Nga ku:

r – data e pagesës së kuponit të instrumentit me norma interesi të lëvizshme;

t – data e maturimit të instrumentit me norma interesi fiks;

N_r – vlera nominale e instrumentit me norma interesi të lëvizshme;

N_t – vlera nominale e instrumentit me norma interesi fiks;

R – bashkësia e të gjitha datave të maturimit për instrumente me norma interesi të lëvizshme;

T – bashkësia e të gjitha datave të maturimit për instrumente me norma interesi fiks.



PBG – Është garanci e cila emetohet nga Banka Botërore dhe garanton plotësisht ose pjesërisht një borxh me qëllim mundësimin e një kostoje më të favorshme se ajo e ofruar nga tregu.

Raport mbulimi – Raporti ndërmjet shumës së kërkuar (*nga investitorët*) dhe shumës së ofruar (*nga shteti*) në ankandet e titujve shtetëror. Shërben për të vlerësuar nivelin e plotësimit të ankandëve dhe gjendjen e likuiditetit.

Rreziku i kursit të këmbimit – I referohet ndikimit të lëvizjes së kursit të këmbimit të një monedhe, mbi nivelin e borxhit dhe shërbimin e tij në një masë të caktuar mbi pritshmëritë.

Rreziku i likuiditetit – Rrezik i asociuar me humbjen e aftësisë së buxhetit të shtetit për të likuiduar detyrimet korrente dhe të ekzekutojë në kohë shpenzimet buxhetore. Me qëllim minimizimin e këtij rreziku, shteti duhet të ketë akses mbi një sasi të caktuar asetesh likuide me qëllim garantimin e fondeve në raste krizash të përkohshme, ku gjatë të cilave bëhet e vështirë ose me kosto të lartë, sigurimi i tyre.

Rreziku i normave të interesit – Rreziku që pagesat e shërbimit të borxhit të ndryshojnë si rrjedhojë e lëvizjes së normave të interesit. Ky rrezik krijohet nga nevoja për të shërbyer borxhin që maturohet dhe pagesat e kuponëve të instrumenteve me norma të ndryshueshme në të ardhmen.

Rreziku operacional – Rreziku i asociuar me rritjen e kostos së menaxhimit të borxhit ose me rritjen e nivelit të risqeve të tjera si rezultat i gabimeve njerëzore, prishjes së pajisjeve elektronike, dëmeve natyrore, etj.

Rreziku i ri-financimit – Rreziku i asociuar me aftësinë për të emetuar instrumente ose marrë hua me qëllim ri-financimin dhe shërbimin e borxhit aktual. Sa më i madh të jetë volumi i shumave që maturohen dhe sa më i afërt në kohë, aq më i lartë është rreziku i ri-financimit dhe anasjelltas. Rreziku i ri-financimit ndikohet nga niveli i borxhit ekzistues dhe profili i amortizimit. Rritja e maturitetit të borxhit dhe shpërndarja në kohë e maturimeve kontribuon në reduktimin e rrezikut të ri-financimit.

Tregu primar – Është hapësira fizike ose funksionale në të cilin Shteti Shqiptar emeton për herë të parë titujt.

Treg sekondar – Është hapësira fizike ose funksionale ku kryhen transaksionet me titujt pasi janë emetuar në tregun primar.

Tituj shtetërorë – Janë bonot e thesarit dhe obligacionet shtetërore të emetuara nga ministria e financave në përputhje me ligjin nr. 9665, datë 18.12.2006, “Për huamarrjen shtetërore, borxhin shtetëror dhe garancitë shtetërore të huasë së Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar; ligjin nr. 9879 datë 21.02.2008 “Për titujt”, si edhe aktet nënligjore.

**VENDIM****Nr. 402, datë 1.6.2016****PËR NJË SHITESË FONDI NË
BUXHETIN E VITIT 2016, MIRATUAR
PËR KRYEMINISTRINË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5 e 45, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 13, të ligjit nr. 147/2015, “Për buxhetin e vitit 2016”, me propozimin e ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kryeministrisë, në buxhetin e miratuar për vitin 2016, në zërin “Shpenzime korrente”, i shtohet fondi prej 60 000 000 (gjashtëdhjetë milionë) lekësh, për ministrin e Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike.

2. Ky fond i jepet, në formën e transfertës, Autoritetit të Mediave Audiovizive, për t’u përdorur për financimin e organizimit të fushatës për informimin e publikut për kalimin e transmetimeve analoge në transmetime dixhitale.

3. Efektet financiare, sipas pikës 1, të këtij vendimi, të përballohen nga fondi rezervë i buxhetit të shtetit, miratuar për vitin 2016.

4. Ngarkohen Kryeministria, ministri i Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI**Niko Peleshi****VENDIM****Nr. 407, datë 1.6.2016****PËR PËRCAKTIMIN E KRITERIT TË
NOTËS MESATARE PËR PRANIMIN E
KANDIDATËVE NË PROGRAMET E
STUDIMEVE TË CIKLIT TË PARË DHE
PROGRAMET E INTEGRUARA TË
STUDIMEVE TË CIKLIT TË DYTË, NË
INSTITUCIONET E ARSIMIT TË LARTË,
PËR VITIN AKADEMIK 2016–2017**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 74, të ligjit nr. 80/2015, “Për arsimin e lartë

dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Arsimit dhe Sportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kanë të drejtën të aplikojnë për t’u pranuar në programet e studimeve të ciklit të parë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë në institucionet e arsimit të lartë kandidatët që kanë përfunduar me sukses nivelin e arsimit të mesëm të lartë dhe që plotësojnë kriterin e notës mesatare të përcaktuar në këtë vendim.

2. Për të gjithë kandidatët, të cilët kanë përfunduar nivelin e arsimit të mesëm të lartë, nota mesatare për pranim në programet e studimeve të ciklit të parë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, në institucionet e arsimit të lartë, për vitin akademik 2016–2017, të jetë 6 (gjashtë). Nota mesatare për pranim në institucionet e arsimit të lartë, përllogaritet si mesatare aritmetike e thjeshtë e treguesve të mëposhtëm:

a) Mesatarja aritmetike e thjeshtë e notave përfundimtare vjetore të lëndëve për të gjitha vitet e shkollimit në arsimin e mesëm të lartë;

b) Mesatarja aritmetike e thjeshtë e notave të provimeve të maturës/Maturës Shtetërore.

3. Kandidatët që aplikojnë për t’u pranuar në programet e studimeve dy vjeçare me karakter profesional nuk kanë detyrimin të plotësojnë kriterin e notës mesatare të parashikuar në këtë vendim.

4. Institucionet arsimore të arsimit të mesëm të lartë dhe njësitë arsimore vendore janë përgjegjëse për përllogaritjen e notës mesatare dhe përcjelljen e të dhënave pranë Agjencisë Kombëtare të Provimeve.

5. Procedurat për njëvlershmërinë e dokumenteve të paraqitura nga shtetasit shqiptarë dhe të huaj, të cilët kanë përfunduar nivelin e arsimit të mesëm të lartë jashtë vendit dhe përllogaritja e notës mesatare për këta kandidatë të kryhen nga Ministria e Arsimit dhe Sportit bazuar në përcaktimet e pikës 2, të këtij vendimi, me përjashtim të rasteve kur nuk aplikohen provime mature, maturë shtetërore apo provime lirimi. Në këto raste me vendim të komisionit përkatës përcaktohet mënyra e përllogaritjes së notës mesatare. Komisioni përkatës përcjell të dhënat



te njësitë arsimore vendore dhe tek Agjencia Kombëtare e Provimeve.

6. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Sportit, Agjencia Kombëtare e Provimeve, institucionet arsimore të arsimit të mesëm të lartë, njësitë arsimore vendore, dhe institucionet e arsimit të lartë, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI

Niko Peleshi

VENDIM

Nr. 408, datë 1.6.2016

PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR. 646, DATË 1.10.2014, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR KALIMIN E PRONËS SË PALUAJTSHME SHTETËRORE, ME EMËRTIMIN “ISH-DREJTORIA E KONVIKTEVE TË SHKOLLAVE TË MESME, TIRANË”, NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI TË MINISTRISË SË DREJTËSISË, DHE PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 834, DATË 13.12.2006, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR MIRATIMIN E LISTËS SË PJESSHME TË INVENTARIT (PJESA E PARË + PJESA E DYTË) TË PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE NË BASHKINË TIRANË, TË QARKUT TË TIRANËS”, SI DHE PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR. 1292, DATË 24.9.2008, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR KALIMIN NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI TË MINISTRISË SË DREJTËSISË TË TROJEVE DHE NDËRTESAVE TË GJYKATAVE TË RRETHEVE GJYQËSORE DHE TË GJYKATAVE TË APELIT”, TË NDRYSHUAR”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 10, 12, 13, 14 e 15, të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001, “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në pikën 1, të vendimit nr. 646, datë 1.10.2014, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, pas fjalëve “...me numër pasurie 2/82...” shtohet “...si dhe të pronës së paluajtshme shtetërore me numër pasurie 2/83/1, të ndodhur në zonën kadastrale 8160, me sipërfaqe 56 m²...”.

2. Ngarkohen Ministria e Drejtësisë dhe kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI

Niko Peleshi

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2016

Adresa:
Bulevardi “Gjergj Fishta”
pas ish-Ekspozitës “Shqipëria Sot”
Tel: 042427005, 04 2427006

Çmimi 434 lekë